



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 03.02.2015, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit
2. Projektligji "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8652, datë 31.7.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", të ndryshuar".

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Oerd Bylykbashi, Armando Subashi, Bashkim Fino, Ulsi Manja, Eduard Halimi, Dashamir Peza, Vasilika Hysi, Mhill Fufi, Silva Caka, Blendi Klosi, Gent Strazimiri, Tom Doshi, Petrit Vasili, Arben Ristani, Vexhi Muçmataj, Tahir Muhedini, Nard Ndoka.

Mungojnë: Pandeli Majko, Fatmir Mediu

Të ftuar:

Bledar Çuçi – ministër i Shtetit për Çështjet Vendore.

Enea Hoti – këshilltar i ministrit të Shtetit për Çështjet Vendore.

HAPET MBLEDHJA

Fatmir Xhafaj – Fillojmë mbledhjen e komisionit. Sot në rendin e ditës kemi shqyrtimin e projektligjit "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8652, datë 31.07.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", të ndryshuar”.

Është i pranishëm ministri i Shtetit për Çështjet Vendore për të prezantuar projektin e qeverisë dhe për t’ju përgjigjur pyetjeve dhe komenteve, që mund të ketë lidhur me këtë projekt.

Faleminderit, zoti Ministër!

Fillimisht do të dëgjojmë ekspozenë e amendamenteve të paraqitura nga qeveria, në ndryshim të ligjit nr. 8652, do të flasë relatori, zoti Fino dhe më pas, do të vijojmë me pyetje dhe diskutime.

Zoti Çuçi, keni fjalën!

Bledar Çuçi – Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Ndryshimet që paraqesim sot për ligjin nr.8652, datë 31.7.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", të ndryshuar”, në kuadrin e zbatimit të reformës administrativo-territoriale dhe miratimit të ligjit nr.115/2014, datë 31.7.2014, “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, përbëjnë dy grupe ndryshimesh.

Së pari, është grupi i ndryshimeve që vjen si nevojë për të harmonizuar dhe përshtatur ligjin e ri “Për ndarjen administrativo- territoriale”, me ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”.

Së dyti, janë disa ndryshime që vijnë pas një axhende të përbashkët që kemi pasur prej kohësh me Këshillin e Europës.

Sa i përket harmonizimit të dispozitave të ligjit “Për ndarjen administrativo- territoriale”, me ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, konsistojnë:

Së pari, në ligj hiqen termat “kryetar komune” dhe “këshill komune”, pasi tani do të përdoret vetëm termi “bashki”, sipas ligjit të ri “Për ndarjen administrativo- territoriale”.

Së dyti, ripërcaktohet raporti i përfaqësimit politik në këshillat e njësive vendore. Duke qenë se janë krijuar njësi më të mëdha, tashmë, nuk kemi njësi me 5 mijë banorë dhe ky kufi fillon dhe përcaktohet që prej njësive me mbi 10 mijë banorë. Si kufi maksimal kemi bërë një

ndarje sa i përket këshilltarëve, pasi ndarja e fundit ka qenë mbi 200 mijë banorë, meqë kemi pasur vetëm një bashki, e cila kishte përcaktim më vete (bashkia e Tiranës) dhe tashmë, kemi 4 bashki mbi 200 mijë banorë, sipas ndarjes së re administrativo-territoriale.

Edhe ky raport është tentuar të rregullohet. Kufiri maksimal i anëtarëve është parashikuar për bashkitë me numër banorësh nga 200001 deri në 400000 banorë të kenë 55 anëtarë këshilli. Për bashkinë Tiranë, që është bashkia më e madhe, propozohet që këshilli i bashkisë të ketë 65 anëtarë.

Së treti, ripërcaktohet numri i përfaqësive së kryesisë së këshillave të qarqeve. Kjo vjen si rezultat i zvogëlimit të numrit të anëtarëve të këshillave të qarqeve, për shkak të hartës së re administrativo-territoriale, sepse një pjesë e madhe nuk janë më anëtarë të këshillave të qarqeve, sepse janë vetëm 61 bashki dhe për këtë arsye, kryesia do të jetë vetëm me kryetarë dhe zëvendëskryetarë dhe jo me nga 5 deri në 9 anëtarë, por aktualisht, në 3 deri në 5 anëtarë.

Një ndryshim tjetër, lidhet me krijimin e administratorit vendor, siç e kemi quajtur, në njësitë administrative. Siç e dimë, në ndarjen e re administrativo-territoriale janë ruajtur territoret administrative të ish-komunave, që tashmë janë pjesë përbërëse të një bashkie të madhe, por për të mos iu larguar me shërbime banorëve që janë brenda një komune ekzistuese, është menduar të ngrihen disa zyra administrative, të cilat do të varen nga qendra, nga bashkia e madhe dhe këto zyra do të ofrojnë shërbimin që ka ofruar deri tani komuna. Është parashikuar ngritja e kësaj strukture dhe këto zyra do të shërbejnë si zyra unike të shërbimit për këta banorë.

Është parashikuar të propozohet administrata e njësisë administrative për të garantuar një proces kalimtar deri në vitin 2017, është menduar me ligj që këto zyra të mbahen deri në vitin 2017 dhe më vonë, të jetë në diskrecionin e këshillave bashkiakë për të vendosur nëse duhet të mbahen, ose jo në zona të caktuara.

Parashikimi i fundit ka të bëjë me harmonizimin e ligjit “Për ndarjen administrativo-territoriale” me ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, është një dispozitë e veçantë për t’i dhënë kompetencën Këshillit të Ministrave për të deleguar të gjitha problemet, që lindin me fazën transitore të amalgimit apo bashkimit të disa njësisve, në njësi më të madhe, si pasojë e hyrjes në fuqi të ligjit të ri “Për ndarjen administrativo-territoriale të Shqipërisë”.

Grupi tjetër i ndryshimeve ka të bëjë me një dialog që kemi me Këshillin e Europës. Propozimi i parë është futja e detyrimit të qeverisë për t’u konsultuar me të gjithë njësitë e

qeverisjes vendore për të gjitha aktet, të cilat prekin funksionimin e qeverisjes vendore. Deri sot nuk ka ekzistuar ky detyrim. Kemi futur pikërisht këtë detyrim duke transpozuar fjalë për fjalë përcaktimin, që bëhet në Kartën Europiane të Qeverisjes Vendore në ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, në mënyrë që të kemi detyrimin për çdo legjislacion dhe çdo akt rregullator që prek funksionimin e qeverisjes vendore, organi propozues është i detyruar të konsultohet me grupet që përfaqësojnë këto interesa.

Një tjetër propozim që vjen në këtë kuadër dhe është konsultuar me KE-në, është një korrigjim për sa i përket të drejtës për të përcaktuar organigramën dhe strukturën e bashkisë. Deri sot, çdo ndryshim i strukturës së organigramës duhej të miratohej në këshillin bashkiak. Ne e shohim të arsyeshme që kjo s’është e nevojshme, sepse këshilli bashkiak duhet të përcaktojë numrin e përgjithshëm të punonjësve dhe fondin e pagave. Mënyra sesi rregullohet brenda funksionimi i bashkisë, ky është diskrecioni i kryetarit.

Këto ishin sa i takon ndryshimeve që paraqiten sot për miratim në ligjin nr. 8652 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”.

Mbetem i hapur për diskutime dhe për pyetje.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Çuçi për ekspozenë tuaj!

Dëgjojmë relatorin, zotin Fino.

Bashkim Fino - I nderuar kryetar,

Falënderoj zotin ministër për ekspozenë!

Unë s’kam shumë gjëra për të thënë. Është një projektligj, që na detyron të bëjmë disa rregullime të ligji nr. 8652, sepse më 21 qershor kemi zgjedhjet lokale dhe me reformën që sapo bëmë për ndarjen e re territoriale, me 61 bashki, s’mund të shkojmë me ligjin ekzistues, në funksion të këtyre 61 bashkive të reja. Kjo do të thotë që do të ndryshojë detyrimisht struktura e këshillave bashkiake, pra, s’do të kemi më 400 këshilla të komunave e të bashkive, por do të kemi vetëm 61 këshilla bashkiakë. Në këtë kuptim, natyrisht, duhet ndryshuar neni përkatës i ligjit.

Janë edhe disa ndryshime të tjera, që vijnë si rezultat i kësaj që thashë më lart, që do të thotë, ne vendosëm që nuk do të kemi më komuna, kështu që në ligj duhet të shfuqizohen termat “komunë”, “kryetar i komunës”, “këshill i komunës”, e kështu me radhë.

Nga ana tjetër, rishikohet dhe përbërja e këshillit, siç e tha dhe zoti ministër, pra, këshillat në përgjithësi (përfashtojnë tri bashkitë e vogla minoritare), një në Pustec dhe dy të Dropullit, në

përgjithësi bashkitë e tjera janë me një tavan prej 30 mijë banorësh, që do të thotë se do ta shikojmë qoftë në ligj dhe qoftë te lagjet e fshatrave të njësive më të vogla, deri te njësia bazë, bashkia, do të jetë në funksion të kësaj ndarjeje të banorëve se cili do të jetë edhe numri i këshilltarëve që do të përcaktohet, siç është në ligj, në çdo fillim viti me një urdhër të prefektit të qarkut për numrin e këshilltarëve për secilën bashki.

Personalisht gjykoj, që formula e përbërjes së këshillave bashkiake duhet të rishikohet në themel, pra, në harmoni me filozofinë e re të përfaqësimit, sipas ndarjes territoriale, sipas zonave rurale dhe urbane, por besoj se kjo do të diskutohet, si pjesë e ligjit të ri të qeverisjes vendore, për shkak të zgjedhjeve vendore të qershorit të vitit 2015, mendoj se formula që është paraqitur sot, është më se e mjaftueshme për zgjedhjet e vitit 2015. Do të flas pak më vonë, kur të ndërhyjmë për ligjin organik në tërësi.

Këtu futet koncepti i administratës së njësive administrative. Në qoftë se kemi një bashki të madhe, dhe bashkia e madhe (këtë e kam për publikun), ka në përbërjen e saj disa bashki të vogla (e kam për publikun këtë sqarim), si për shembull bashkia Kukës, që ka përfshirë të gjitha ish-komunat, atëherë, do të themi se është njësia administrative e kësaj komune, e bashkisë së Kukësit.

Përse e vumë konceptin e njësive administrative? Këtë e vumë si nocion për të referuar, sepse kemi deklaruar që në fillim, se shërbimet nuk do t'i largojmë nga qytetarët. Pra, këto njësi administrative do të mbeten, siç kanë qenë me një bazë numri punonjësish të caktuar në ish-komunën, por kanë varësi direkt nga bashkia qendrore dhe emërimin e kryetarit të njësive dhe të punonjësve, e bën kryetari i bashkisë përkatëse. Ky është efekti i ri. Quhet njësi e re administrative dhe ndërkohë, kryetari i bashkisë përkatëse, miraton organigramën dhe funksionalitetin e bashkisë dhe të këtyre kryetarëve. Nuk do të ketë më zgjedhje në bashkinë e Tiranës, por do të ketë zgjedhje për kryetarin e bashkisë së Tiranës, do të ketë njësi administrative të Tiranës (si ajo e Dajtit dhe njësive nr,1, 2, 3, 4 e pesë), por nuk do të ketë zgjedhje të drejtpërdrejta nga populli, por do të ketë vetëm për kryetarin e bashkisë së Tiranës, i cili do të emërojë kryetarët e njësive administrative përkatëse, brenda hartës që mbulon. Natyrisht, ata kanë të drejtë që të bëjnë edhe pjesën administrative dhe pjesën e organigramës përkatëse. Këto ndryshime vijnë si rezultat i reformës territoriale dhe ndryshimeve të shpejta, që i kemi bërë ligjit.

Qeveria e ka sjellë këtë projektligj që në nëntor 2014, pavarësisht, se ne po e shqyrtojmë pas 2 muajsh.

Meqë kam drejtuar Komisionin për Reformën Territoriale-Administrative, dua të them se ligji nr. 8652 është një ligj shumë i rëndësishëm, i cili ka kaluar me 5/5 e votave dhe është një ligj, që kërkon mirëkuptimin e opozitës. Këto janë disa amendamente në funksion të zgjedhjeve dhe nuk kanë se përse të hidhen poshtë.

Kjo është arsyeja që kaluam disa amendamente dhe s'jemi gati për të bërë një ligj të ri, nga e para dhe në kuadrin e kushteve dhe të sugjerimeve. Meqë kemi dhe ministrin këtu, do ta pyesja: kur është gati qeveria të na sjellë një ligj të ri organik për decentralizimin e pushteti vendor, pavarësisht se sot po kalojmë disa ndryshime në nenet përkatëse, në funksion të zgjedhjeve të qershorit?

Kjo është pjesa më e rëndësishme, ku duhet të marrin pjesë aktive të gjitha grupet parlamentare. Ne duhet ta kalojmë me konsensus të plotë ligjin e ri organik për pushtetin vendor, sepse ju shërbejmë njerëzve, sepse kryetarët e bashkive dhe këshilltarët do të jenë të forcave të ndryshme politike dhe do t'u duhet atyre ky ligj organik, i decentralizuar, ashtu siç kemi kërkuar edhe ne, edhe PD-ja në programet respektive, të bëjmë një ligj sa më decentralizues dhe është koha që pas 14 vjetësh, të bëjmë një ligj të rishikuar. Mendoj se pas zgjedhjeve të qershorit, është më se i domosdoshëm rishikimi i ligjit, për të marrë mendimet, sugjerimet:

- E 61 kryetarëve të bashkive, që do të jenë personalitete të çdo fushe dhe të çdo partie politike;

- Të këshillave përkatëse që do të jenë në këto bashki dhe natyrisht, do të jetë edhe ndihma e donatorëve të huaj, të cilët edhe atëherë, kur e kemi bërë ligjin nr. 8652, të vitit 2000, u kemi marrë mendimet e sugjerimet, edhe në kuadër të Kartës për Autonominë Vendore, për të miratuar dhe për të zgjidhur dhe për të bërë një ligj të caktuar, ligjin organik për pushtetin vendor.

Kjo bëhet edhe për të marrë disa kompetenca. E kam thënë gjithmonë, se është një luftë e papajtueshme midis pushtetit qendror dhe atij vendor. Kështu është në Europë, në të gjitha vendet e botës dhe kështu është edhe në Shqipëri. Ka një luftë të papajtueshme: sa më shumë kompetenca kërkon të marrë pushteti vendor, aq më shumë pushteti qendror nuk do t'i japë ato.

Ne duhet të realizojmë një ligj organik, që t'u përgjigjet shumë mirë këtyre që kemi arritur, por duhet të arrijmë akoma më shumë në funksion të decentralizimit.

Decentralizim do të thotë, të kenë më shumë kompetenca, më shumë mundësi për kryetarët e bashkive dhe këshillat përkatëse, për të bërë drejtimin e tyre, do të thotë, që me ligjin

e ri, t'u japim mundësi drejtimi në arsim, shëndetësi mjedis dhe të mos jenë kompetencat e emërimeve dhe shkarkimeve, te ministritë përkatëse.

E kam thënë edhe një herë tjetër: ministritë kanë në dorë të bëjnë politikat arsimore, shëndetësore, mjedisore, por nuk kanë të drejtë të bëjnë politika për emërimet dhe shkarkimet. Ato janë kompetencë e pushteti vendor (sipas mendimit tim). Pra, ka ardhur momenti, që, kur të bëjmë ligjin e ri organik për decentralizimin e pushteti vendor, duhet të japim mendime të gjithë bashkë dhe të kemi konsensus mbarëparlamentar, që ta kalojmë sa më unanimisht dhe jo më, me 84 vota, që mund t'i ketë çdo forcë politike.

E bëra këtë rezymë dhe këtë pyetje për ministrin, për të treguar që këto janë ndryshime të thjeshta, që duhen bërë patjetër, janë të detyrueshme për zgjedhjet e qershorit dhe natyrisht, s'kemi se çfarë të themi, përjashtoj ndonjë gjë të vogël, që do ta them gjatë shqyrtimit nen për nen.

Si përfundim, u kërkoj të gjithë kolegëve ta votojnë këtë projektligj, sepse është në funksion të zgjedhjeve të 21 qershorit.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Fino!

Zoti Çuçi, keni fjalën!

Bledar Çuçi – Faleminderit, zoti kryetar!

Thjesht, për t'iu përgjigjur zotit Fino, mund t'ju them, se ashtu siç tha ai, ka pasur dy iniciativa për ligjin "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore".

E para, është kjo që ju kemi sjellë sot për shqyrtim dhe për miratim, e cila thjesht, harmonizon dispozitat e domosdoshme të ligjit "Për ndarjen administrativo- territoriale", me ligjin "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore".

Ne, si qeveri, kemi marrë një iniciativë tjetër, për të ribërë një ligj krejtësisht të ri për qeverisjen vendore. Jemi në fazën e formimit të ekipit të ekspertëve, sepse duam të marrim ekspertë vendas dhe ndërkombëtarë. Ekspertët vendas për këtë çështje nuk mungojnë në Shqipëri, në mënyrë që të kemi një produkt sa më të mirë, sa më profesional, për ta shtruar për diskutim me të gjithë grupet e interesit dhe më gjerë, me pjesën politike, deri në miratimin e tij.

Kemi në plan që brenda muajit maj, të kemi gati draftin e një ligji të ri për qeverisjen vendore.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Çuçi!

Kush ka pyetje?

Urdhëroni, zoti Bylykbashi.

Oerd Bylykbashi – Zoti kryetar,

Para se të bëj pyetje, kisha dy komente të shkurtra për procesin dhe një sugjerim. Siç e tha edhe ministri, edhe relatori, zoti Fino, ky ligj është një ligj shumë i rëndësishëm që miratohet me 3/5 dhe jo vetëm për këtë, por është një nga ligjet, i cili rregullon një pjesë shumë të madhe të funksionimit të shtetit dhe si i tillë, kërkon një qasje të pjekur, të matur, pa nxitim, të konsultuar dhe sa më gjithëpërfshirëse.

Këtë na e detyrojnë edhe dokumente shumë të rëndësishëm, që ka sot parlamenti apo shteti shqiptar. Është rezoluta e 2 tetorit e Asamblesë Parlamentare të KE-së, e cila në mënyrë specifike i dedikon një pjesë reformës për decentralizimin e pushtetit vendor dhe në mënyrë konkrete kërkon, që ky ligj të rishikohet dhe të amendohet.

Më konkretisht: “Të sigurohet raporti i përgjegjshmërisë i kryetarëve dhe këshillave të zgjedhur”, por në lidhje me procesin, flet që duhet të bëhet në konsultim dhe me konsensus politik, por mbi të gjitha, në diskutim me autoritetet lokale të përfshira.

Të mos harrojmë, se më 24 tetor me një ndërmjetësim të fortë të BE-së, kemi një marrëveshje të ratifikuar, e cila kërkon që ligjet e rëndësishme me shumicë të cilësuar, të bëhen, duke mos anashkaluar opozitën thjesht, me shumicën e votave (dëgjova të fliste edhe zoti Fino për këtë), por të bëhen duke kërkuar konsensus me opozitën.

Unë mendoj se decentralizimi nuk është thjesht një parim kushtetues, por është një çështje shumë e rëndësishme. Ne duhet të bëjmë përpjekje që të decentralizojmë sa më shumë pushtetin. Beteja që përmendi zoti Fino, duam të fitohet nga pushteti vendor, jo nga pushteti qendror, pra, pushteti të jetë sa më pranë qytetarëve.

Për fat të keq, aktualisht, ndodh e kundërta dhe kemi marrje kompetencash nga qeverisja qendrore.

Fatmir Xhafaj – O bëni pyetje, o flisni për procedurë!

Nuk kemi ardhur te diskutimet.

Oerd Bylykbashi – Tani po vij te propozimi.

Duke qenë se kemi para një ligj kaq të rëndësishëm, gjykoj, duke u nisur edhe nga kalendari që propozohet për miratim, meqë kjo çështje do të jetë në seancën e datës 26 shkurt, besoj se kemi kohën e mjaftueshme, për të shkuar te ajo që rekomandohet: “Një proces i konsultuar sa më mirë”. Ne kemi kohë të programojmë dhe të thërrasim këtu shoqatat e pushtetit vendor, të

cilat operojnë në Shqipëri, kanë një status ligjor të tyre dhe janë shumë aktive në këtë proces. T'i thërrasim dhe t'i dëgjojmë ato.

E thanë edhe ministri, edhe relatori: këto janë thjesht mballoma që po i bëhen këtij ligji, sepse do t'u bëka një ligj i ri.

Të shohim se çfarë mendojnë ato: në këtë kuadër a mund të përmirësohet diçka më tepër, a mund t'u jepet atyre më shumë pushtet? Ne nuk e dimë se kur do të vijë ligji i ri. Le t'i thërrasim dhe t'i dëgjojmë edhe ekspertët e KE-së që të na thonë se çfarë mendojnë ata, se cilat janë problemet.

Besoj që ky do të ishte një proces, i cili do t'i shërbente më shumë, jo vetëm transparencës, por dhe konsultës më të mirë për ne, në mënyrë që të marrim vendime të pjekura. Nuk besoj se ministria ka ndonjë problem.

Para se të bëjmë debate më në detaje për këtë çështje, besoj se mund t'i thërrasim, t'i dëgjojmë dhe sugjerimet e tyre t'i marrim parasysh për ta bërë më mirë.

Të mos harrojmë se flasim për decentralizim, por ka 1 mijë zyra të dekoncentruara të pushtetit qendror, në nivelin e qarkut. Përse të mos t'i dëgjojmë?

Fatmir Xhafaj – Bëni propozimin dhe mbylleni! Mos bëni diskutim!

Oerd Bylykbashi – Zoti Xhafaj,

Ky është propozimi, s'është diskutim: ta merrni me qetësi ligjin "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore".

Fatmir Xhafaj – Në rregull, mund ta kishit thënë me dy fjali.

Zoti Çuçi, keni fjalën!

Bledar Çuçi – Faleminderit, zoti kryetar!

Bashkohem me shqetësimin e zotit Bylykbashi dhe pikërisht për këtë ne do të bëjmë një ligj të ri për qeverisjen vendore, me konsensus sa më të gjerë që të jetë e mundur, edhe politik, por mbi të gjitha, me aktorët e interesit dhe prandaj, e kemi ndarë procesin në dy faza.

Këto dy ndryshime që ju kemi sjellë, janë thjesht për harmonizimin me ligjin "Për ndarjen e re administrativo-territoriale", me qëllim zgjedhjet vendore të radhës, por edhe për këto ndryshime, që janë thjesht harmonizim me një ligj të caktuar, e kemi bërë procesin e konsultimit. U kemi çuar ftesë dhe projektin që në tetor, të gjitha shoqatave dhe organizmave të tjera që merren me çështjen e qeverisjes vendore në Shqipëri dhe më 10 tetor, kemi organizuar një tryezë me shoqatat. Për hir të së vërtetës, shoqatat e komunave dhe shoqatat për autonominë vendore na

kanë sjellë me shkrim mendimin e tyre për këtë draft. Shoqatat e tjera nuk kanë reaguar. Gjithsesi, u thashë se ai shqetësim është në rregull. Ne do të bëjmë një proces konsultimesh, për të arritur konsensusin për sa i përket ligjit të ri "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore".

Ajo që keni ju përpara nuk është ligji i ri dhe po ta shihni projektin, nuk kemi tentuar të hymë në asnjë kompetencë të qeverisjes vendore, sepse kjo gjë do të bëhet me një proces të gjerë konsultimesh, siç e do një ligj i tillë. Ne kemi bërë vetëm ndërhyrje, që lidhen me ndarjen e re administrativo- territoriale.

Për këtë arsye, mendoj që dhe çështja e konsultimeve sa i përket draftit të propozuar nga qeveria, është kapërcyer, sepse me të gjitha shoqatat kemi një korrespondencë të posaçme për këto amendamente, që po ju paraqesim sot.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Çuçi!

Zoti Fino!

Bashkim Fino – Nëse kolegu Bylykbashi kërkon që procesi i këtij komisioni të jetë sa më transparent, s'ka asnjë lloj problemi. Sot po bëjmë diskutimin në parim. Në seancat e tjera pavarësisht se ministri e shprehu qartë dhe tha se janë bërë konsulta me shoqatat dhe aktorët e interesit, ne si komision mund të komunikojmë hapur për këtë draft, edhe me aktorët e tjerë të interesit: me KE-në, me shoqatat e bashkive dhe komunave dhe s'e kemi problem, meqë kemi për ta kaluar projektligjin në seancën plenare të datës 26 shkurt.

E vetmja gjë që të jemi të sigjertë me njëri-tjetrin dhe të mos bëjmë sikur dikush e do më shumë pushtetin vendor dhe dikush e do më pak, dikush do më shumë decentralizimin dhe dikush e do më pak (ai që e do më shumë decentralizimin, jam unë dhe s'është as Bylykbashi, as Çuçi), sepse kam një jetë që luftoj dhe kam bërë ligjin aktual, i cili ishte nga më të mirët në atë kohë dhe të jetë edhe më i mirë tani në vitin 2015 dhe pushteti vendor të jetë me të vërtetë i decentralizuar.

Fatmir Xhafaj – A ka mundësi?

Bashkim Fino – Është e drejta ime ta them atë.

Kur them që të jemi të sigjertë me njëri-tjetrin, dua të them që të mos bëjmë sikur na dhimbset pushteti vendor dhe duam të thërrasim shoqatat. Unë e thashë pak më parë: janë bërë disa amendamente në funksion të ndarjes së re territoriale.

Duke ardhur zgjedhjet e 23 qershorit, s'mund të vemi me 384 njësi vendore, sepse nuk janë më. Nuk do të jenë më 384 këshilla bashkiakë dhe komunash (e kam për publikun, s'e kam për Bylykbashin, se ai e di këtë).

Meqë nuk do të vemi të votojmë për 384 njësi vendore, por do të votojmë për 61 bashki dhe për 61 këshilla bashkiakë, a duhet ta bëjmë ndryshimin në ligj?

Kjo është imediate.

Si do të veprojmë për këto ish-njësitë vendore? A do t'i lëmë si njësi administrative? Po.

Si do t'i emërojmë këta, me zgjedhje apo me emërim?

Unë mendoj ta bëjmë me emërim. Pra, këto janë 3-4 ndryshimet, që janë bërë.

Koncepti tjetër është ai që kryetarët e bashkisë miratojnë organigramën e bashkisë së madhe dhe të njësive përkatëse. Pra, kemi paraqitur në komision 3-4 ndryshime që janë në funksion të zgjedhjeve.

Që ta kënaq edhe Bylykbashin, pavarësisht, se nuk ishte shumë i sinqertë: a duam transparencë edhe për këtë?

Unë jam gati edhe si kryetar i Nënkomisionit për Pushtetin Vendor), që të mos mbaj të gjithë Komisionin e Ligjeve, se ai është një komision shumë i rëndësishëm).

Nëse ju na jepni të drejtën që Nënkomisioni për Pushtetin Vendor, që ka 3 anëtarë nga maxhoranca dhe 2 anëtarë nga opozita, nuk e di se kush vendos nga opozita, të bëjë disa mbledhje të tjera, mendoj unë, pasditeve në procesin e këtij nënkomisioni për të marrë mendime nga shoqata të ndryshme për këtë projektligj, pavarësisht se ministri tha që i kemi marrë, unë jam gati që t'jua propozoj, t'i vëmë në rendin e ditës dhe në ditët në vazhdim të thërrasim shoqatat për këtë projektligj.

Unë mendoj se edhe po ta tejkalonim këtë gjë, edhe po të bënim sot një diskutim në parim, edhe në qoftë se do ta linim një herë tjetër dhe ta bënim nen për nen kur të na binte radha, mendoj se ne si Komision Ligjesh jemi aq në gjendje për ta kaluar dhe për të qenë ky ligj efektiv vetëm për zgjedhjet e 21 qershorit.

Gjithsesi, unë ju bëra një propozim dhe një alternativë më interesante sesa ajo e zotit Bylykbashi. Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Ju e bëtë propozimin tuaj, një pro, një kundër. Në këtë rast janë të dy pro.

(Diskutime pa mikrofon)

A ka mundësi të ta jap unë fjalën? A bëtë një kërkesë, apo jo? Jo, nuk ta jap fjalën, sepse e bëre kërkesën.

Oerd Bylykbashi - Është një gjë që e kundërshton, për më tepër që nënkomisioni nuk është efektiv se nuk e ka antarësimin...

Fatmir Xhafaj – E ka anëtarësinë. Jo, nuk është ashtu siç thoni ju. Njësoj do të bëhet transparent, pasi transparenca njësoj realizohet, publike dhe me kamera do të jetë. Nuk ka asgjë dhe për këtë janë nënkomisionet. Nëse nuk i keni të dy anëtarët tuaj, atëherë i propozoni. Ne i kemi tre anëtarët e komisionit: zotin Bashkim Fino, zotin Petrit Vasili dhe zotin Dashamir Peza.

(Diskutime pa mikrofon)

...E njëjta gjë është, çfarë të dëshironi...

Oerd Bylykbashi – Asnjë lloj difference, për më tepër të dëgjojmë të gjithë anëtarët e komisionit dhe të marrim një vendim së bashku.

Fatmir Xhafaj – Janë të lirë të gjithë anëtarët e komisionit të marrin pjesë, por komisioni ka një axhendë tjetër dhe nuk ka arsye pse ky komision të dublojë një nënkomision.

(Diskutime pa mikrofon)

Fatmir Xhafaj – Prandaj janë nënkomisionet, sepse seancë do të bëjë.

Oerd Bylykbashi – E keni gabim. Ta thotë marrëveshja një gjë në dhjetor, në janar është hera e dytë.

Fatmir Xhafaj – Çfarë ka ndonjë...

Oerd Bylykbashi – E keni te paragrafi i parë, por nuk e keni lexuar ashtu siç duhet, prandaj duhet të thërrasim ndonjë nga ata që e kanë firmosur.

Fatmir Xhafaj – Ta ktheu përgjigjen menjëherë zoti Vasili. Nuk e ke të shkruar në marrëveshje; ta kishe shkruar në marrëveshje, por të ka shpëtuar kjo, e para.

Ka mundësi të lutem, bëre një propozim, të lutem, tani duhet të dëgjosh.

Ju mendoni ta hedh në votë? Unë po të them që të gjejmë në zgjidhje. Po të jetë sipas Rregullores, bëje një kërkesë, firmose dhe sille, siç e kërkon Rregullorja. Pra, sille sipas Rregullores.

Unë nuk po të them këtë, po të them hajde të gjejmë një zgjidhje. Besoj se do ta gjejmë një zgjidhje deri në fund.

Fillojmë diskutimin dhe në fund do të vendosim, ose do ta bëjmë me komision, ose me nënkomisionin, do të vendosim. Do ta bëjmë dhe kjo është e rëndësishme, pastaj se si, është një çështje tjetër.

Vazhdojmë me pyetjet dhe diskutimet.

Po, zoti Halimi!

Eduard Halimi – Zoti Ministër,

Për të qenë të sinqertë, siç tha edhe kolegu, ne këtu, por më tepër me mediat dhe me qytetarët, në korrik, kur ju miratuat ligjin “Për reformën territoriale”, Kryeministri doli para shqiptarëve dhe tha: “Tani do ta miratojmë ligjin “Për reformën territoriale”, në shtator do të fillojmë ligjin “Për decentralizimin e pushtetit””. E kanë mediat të qartë, t’u kthehen kronikave dhe këtë që po them unë e ka thënë në parlament disa herë, në parlament edhe jashtë. “Në shtator”, tha, “do të fillojmë ligjin “Për decentralizimin””.

Vijmë pas 7 muajsh, në shkurt, dhe nuk ka asnjë fjalë për decentralizimin. Pyetja ime, për të qenë i sinqertë me qytetarët shqiptarë, është: nuk ju dolën 7 muaj juve për të filluar për të shkruar një rresht për decentralizimin, apo doni që t’i lemë edhe disa muaj të tjerë, disa vite të tjerë Kryeministrit që të mbajë nën sqetull kompetencat dhe t’i vërë shkelmin në fyt qeverisjes vendore me arbitraritet? Për 3 muaj ju bëtë ligjin “Për reformën territoriale”. Cila është arsyeja që për 7 muaj nuk bëtë një rresht të vetëm për decentralizimin, por vini këtu me një projektligj pa asnjë fjalë për decentralizimin? Kjo është pyetja e parë. Kam edhe katër pyetje të tjera, të cilat do t’i bëj bashkë, por dua përgjigjen e pyetjes së parë dhe pastaj katër pyetjet e tjera i keni rresht.

Fatmir Xhafaj – Një herë me të gjuajtur një nga një, pastaj me batare.

Blendi Çuçi – Faleminderit, zoti Halimi!

Unë nuk e di se ku e ke dëgjuar deklaratën, por, gjithsesi, edhe po të ketë qenë një deklaratë e tillë, ka qenë një ftesë për opozitën që të përfundonte bojkotin parlamentar dhe të ishte pjesë pikërisht e proceseve politike të rëndësishme, siç është edhe bërja e një ligji apo gjetja e një modeli të ri të qeverisjes vendore në kushtet aktuale të zhvillimit të Shqipërisë. Fatmirësisht, kjo ftesë u dëgjua vetëm në fund të dhjetorit të vitit të kaluar, tani sa kaloi janari dhe ne e marrim të mirëqenë përfshirjen edhe të opozitës në këtë proces, kështu që tani fillojmë procesin e hartimit të një legjislacioni të ri për qeverisjen vendore.

Jua thashë këtë, sepse duhet që në fazën e projektimit të ligjit ne duhet të përfshijmë ekspertët më të mirë vendas dhe të huaj, prandaj mendoj që klima e përgjithshme shoqërore e

politike është e favorshme vetëm pas janarit të këtij viti për të bërë një gjë të tillë. Siç jua thashë, ato janë deklarata që ju i keni dëgjuar, por unë kam përpara programe të miratuara të qeverisë, ku flasin shumë qartë për një axhendë sesi do të shkojë drejt bërjes së një ligji kaq të rëndësishëm, siç thatë edhe ju, që në fakt rregullon çështjet më të rëndësishme për sa i përket qeverisjes direkte ndaj qytetarëve dhe komuniteteve, rritjes të cilësisë së shërbimeve, marrjen e shërbimeve cilësore dhe eficiente, kështu që mendoj se jemi në kohën e duhur.

Është e natyrshme që modeli i ri i qeverisjes vendore të fillojë me modelin e ri të strukturës administrative territoriale të Shqipërisë, që do të vijë pas zgjedhjeve vendore të vitit 2015. Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Ministër!

Fjalën e ka zoti Halimi për vazhdimin e pyetjeve.

Eduard Halimi – Kam katër pyetje rresht dhe besoj se do t’u përgjigjesh shkurt, ndoshta. A e zgjidh ky projektligj problemin e madh të arbitraritetit të qeverisë me mbledhjen e taksave, administrimin e të ardhurave apo vazhdon me të njëjtën gjendje të konfliktualitetit derisa të na zgjidhen drejtuesit e rinj të bashkive, më 21 qershor?

Pyetja e dytë. A e zgjidh ky projektligj problemin e arbitraritetit të Kryeministrit me bllokimin selektiv të fondeve të komunave dhe bashkive me projekte zhvillimore dhe buxhetet e tyre? Ka një shkresë të Ministrit të Financave, që ka bllokuar fondet e të gjitha komunave në mënyrë selektive, jo të të gjithave, por në mënyrë selektive për vitin 2015, por a e zgjidh këtë problem ky ligj? A e zgjidh ky ligj problemin e arbitraritetit të Kryeministrit, për bllokimin e lejeve të ndërtimit sa herë Kryeministrit i shkon në mendje dhe për inat të kryetarëve të komunave, në mënyrë selektive bllokon dhënien e lejeve të ndërtimit?

Pyetja e fundit. A e zgjidh ky projektligj arbitraritetin e pushtetit qendror të Kryeministrit për anulimin selektiv të lejeve të ndërtimit apo për bllokimin selektiv të projekteve të zhvillimit nga ana e tij?

Këto janë pyetjet që kisha unë.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Zoti Ministër, ju lutem!

Blendi Çuçi – Faleminderit, zoti kryetar!

Pavarësisht se pyetjet ishin tërësisht politike, por në respekt të komisionit, do më duhet të jap një përgjigje dhe përgjigjet e mia janë që në gjykimin tim nuk ka arbitraritet në mbledhjen e

taksave, nuk ka arbitraritet në ndarjen e fondeve të qeverisjes vendore, përkundrazi, ka pasur një rritje në raport me GDP-në më të madhe të bërë ndonjëherë këtë vit për qeverisjen vendore.

Për sa u përket çështjeve të komunave, është e natyrshme që në 1 vit elektoral, ku 6 muaj do të kemi 373 njësi dhe 6 muaj do të kemi 61 njësi, bashki, është e natyrshme që edhe buxheti për pjesën e komunave, të cilat do të shkrihen dhe nuk do të ekzistojnë pas zgjedhjeve vendore, të jepet buxhet vetëm për periudhën që ato ekzistojnë. Nuk mund të jepet buxhet për një njësi vendore, e cila nuk ekziston, prandaj edhe për sa i përket ndarjes së fondeve të komunave u është dhënë një buxhet dhe kjo është dhënë në mënyrë të njëtrajtshme dhe është miratuar në parlament vetëm për pjesën që ato do të ekzistojnë ligjërisht si komuna, pra periudha përpara zgjedhjeve vendore. Nuk ka një abuzim në dhënien apo në bllokimin e lejeve të ndërtimit, në gjykimin tim, dhe për çdo çështje që mund të jetë ligjore opozita i ka të gjitha mjetet, ashtu siç edhe i ka përdorur, për të vërtetuar nëse këto janë veprime abuzive apo jo. Jetojmë në një shtet demokratik, ka shumë dimensione shteti, kështu që mendoj se nuk është çështje e këtij komisioni diskutimi i këtyre amendimeve. Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Ministër!

A ka pyetje të tjera?

Po, zoti Bylykbashi!

Oerd Bylykbashi – Zoti Ministër, ju publikisht, gjatë procesit të bërjes së hartës së re, keni deklaruar në publik edhe me ndërkombëtarët që ndryshimet që do të bënit nuk do të kishin ndikim mbi ligje të tjera të rëndësishme. Tani ju vetë e kuptoni, e thoni, e pranoni që do t’ju duhet të ndryshoni Kodin Zgjedhor, do t’ju duhet të ndryshoni ligjin organik, ndoshta edhe ligje të tjera, do t’i shohim pasojat më mbrapa. Opozita ju bëri propozimin në atë kohë që, në vend që të merreshit vetëm me hartën, komisioni të ulej të bënte edhe këto, diskutimin e këtyre kompetencave, edhe hartën, edhe çdo ndikim tjetër që do të kishte në Kodin Zgjedhor dhe së bashku ta kopsitnim mirë. Një pyetje fillimisht: ju e kuptuat në kohën kur bëhej harta, e kuptuat që po e nisnit nga patkoi dhe do të kishit ndikim, apo nuk e kuptuat fare këtë, sepse, nëse nuk e keni kuptuar, i bie që ta keni bërë në mënyrë të qëllimshme. Doja të dija a bëtë një vlerësim ju për ndryshimet që do të shkaktonte harta territoriale tek e gjithë korniza tjetër e rëndësishme në këtë vend, Kod Zgjedhor, ligj organik dhe ligje të tjera, duke përfshirë edhe autonominë financiare, përfshirë edhe aspekte se si do të menaxhohen fondet e pushtetit vendor?

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Fjala për ju, zoti Ministër!

Blendi Çuçi – Faleminderit që i ke ndjekur në distancë të gjitha diskutimet që ne kemi bërë vitin e kaluar, por ne vazhdimisht ju kemi ftuar pikërisht që të diskutojmë edhe për këto gjëra që janë komplementare me ndarjen e re administrative-territoriale. Në gjykimin tonë, problemi fillon të zgjidhet duke bërë një hartë të re administrative-territoriale dhe këtë e kemi thënë shumë qartë, gjatë të gjitha debateve që kemi pasur. Këtë e kemi thënë me ndërkombëtarët, e kemi thënë me Këshillin e Europës dhe kemi marrë miratimin e plotë të të gjithë ekspertëve vendas dhe të huaj për qasjen që ne kemi pasur në ligje me ndryshimin e hartës administrative-territoriale dhe pastaj të fillojmë dhe të mendojmë për fuqizimin e qeverisjes vendore, sepse nuk ka qenë problem sasia e kompetencave, funksioneve që ka pasur dhe që ka sot me ligj qeverisja vendore për funksionimin e qeverisjes vendore, nuk ka qenë ky problem, sepse sot që flasim vetëm 15% e njësisve të qeverisjes vendore arrijnë të realizojnë mbi 80% të funksioneve dhe kompetencave që sot ligji u jep.

Pra, nuk është problemi te niveli i decentralizimit i dhënë me ligj, por problemi është shumë i thellë dhe i gjithë ky debat...

(Diskutime pa mikrofon)

... më lini të përgjigjem. I gjithë ky debat është i shtjelluar në mënyrë të detajuar, në të gjitha analizat që janë pjesë e ligjit “Për ndarjen e re administrative-territoriale të vendit”, ka qenë pjesë e diskutimeve kushtetuese që kemi pasur për këtë çështje në Gjykatën Kushtetuese, e cila na dha të drejtë jo vetëm për ligjin, por edhe për qasjen që ne kemi ndjekur. Ne asnjëherë nuk kemi thënë që një ligj kaq i rëndësishëm dhe madhor, siç është ristrukturimi i të gjithë territorit dhe i pjesës administrative-territoriale të Shqipërisë, i funksionimit administrativ-territorial nuk shoqërohej me amendime, të cilat nuk kapin thelbin qoftë të çështjeve zgjedhore, qoftë të çështjeve për funksionimin e qeverisjes zgjedhore dhe kjo vërtetohet edhe sot, sepse ne kemi thënë që do të bëjmë ndryshime në hartën administrative territoriale, por nuk do të prekim pjesët që lidhen me çështje që kanë të bëjnë me sistemet zgjedhore apo me çështje politike që lidhen me zgjedhjet. Për shembull, kemi thënë, në qoftë se e mbani mend, që po i lëmë qarqet mënjane dhe nuk po i prekim pikërisht, sepse po të preknim edhe qarqet, po të ndryshonim edhe hartën e qarqeve, do të ndryshonim në mënyrë indirekte edhe përcaktimin apo ndarjen e mandatit brenda një njësie zgjedhore për çështje parlamentare meqë kemi një sistem proporcional rajonal.

E kemi thënë shumë qartë këtë gjë, pra nuk do t'i prekim ato çështje, të cilat na çojnë në prekje të sistemit zgjedhor dhe për këtë ne kemi pasur një qëndrim shumë të qartë. Pa opozitën nuk mund të prekim sistemin zgjedhor dhe ky është një qëndrim shumë i qartë nga ana jonë, i artikuluar shumë qartë dhe i mbajtur deri tani. Ndryshimet që ne sjellim janë ndryshime thellësisht teknike që përshtatin pikërisht këtë gjë, atë që keni pasur merak edhe ju, pasi keni thënë që duhet pasur kujdes me raportin e përfaqësimit të këshilltarëve në këshilla me popullsinë.

(Diskutime pa mikrofon)

Pa diskutim që e kemi mbajtur shënim dhe jemi përpjekur të ruajmë prapë logjikën që ka ligji i sotëm i qeverisjes vendore pa e ndryshuar atë, sepse ndoshta për një zgjidhje më afatgjatë do të donim një ndryshim krejt tjetër të sistemit zgjedhor të këshillave të qeverisjes vendore. Kemi mbajtur po atë logjikë që ka ligji sot, vetëm kemi tentuar që një bashki me 200 mijë banorë të mos ketë të njëjtën numër këshilltarësh me një bashki me 500 mijë banorë, sepse po të lexojmë ligjin sot, me ndarjen administrative do të kishim të njëjtin numër këshilltarësh si në një bashki me 200 mijë banorë, ashtu edhe në një bashki me 500 banorë. Këtë gjë po tentojmë ta rregullojmë sot, pasi është një shqetësim i drejtë ai që kemi pasur.

Nuk do të doja ta rihapnim debatin për këtë çështje, e kemi bërë edhe në distancë, e kemi bërë edhe në Gjykatë Kushtetuese, besoj se tashmë i kemi kapërcyer këto gjëra dhe mendoj që le të shërbejë ky si një sinjal i mirë që hajde të ulemi, atë që tha edhe zoti Fino, të bëjmë një ligj të mirë për qeverisjen vendore bashkërisht. Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

A ka pyetje të tjera?

Oerd Bylykbashi – Në lidhje me këtë të fundit që thatë ju, zoti Çuçi, po jua përsëris këtu qëndrimin tonë. A ka mundësi?

Fatmir Xhafaj – Jo, nuk ka mundësi fare. Po fliste më parë ministri, ndërhyre dhjetë herë dhe nuk paske durim të dëgjosh përgjigjen tënde, siç bëri kolegu yt.

Oerd Bylykbashi – Të vazhdoj të bëj pyetjen, mos ndërhy.

Zoti Çuçi, jua përsëris se atë hartë që keni bërë ju nuk ta pranon njeri, gjithsesi është puna juaj, do t'jua faktojmë rrugës ne këtë. Është e qartë që një pjesë juaja nuk e ka kuptuar, se ndoshta nuk e kuptuat as pyetjen, ku ishin të lidhura bashkë të tri elementet dhe një pjesë nuk ka dashur, sepse normalisht nuk shkohet përpara te nallbani për të blerë patkoin, siç ka bërë Rama kësaj radhe, por blihet kali, pastaj patkoi. Megjithatë, duke qenë se sot del qartazi që këto janë ndryshime të

rëndësishme, do të ndryshohet Kodi Zgjedhor për dispozita jo të tërthorta, por të drejtpërdrejta të organizimit të zgjedhjeve dhe shumë shpejt do ta kemi këtë diskutim besoj. Përgjigjja juaj është e kithët me pyetjen që bëra.

Pyetja tjetër. Keni mbajtur shënim shqetësimin dhe jeni përpjekur që të bëni përmirësim të raporteve të përfaqësimit në këshillat e ndryshëm, sigurisht që çështjeve që ngriti zoti Halimi nuk u jepni dot përgjigje, bllokimi i kompetencave, marrja e kompetencave në aspektin financiar, por a mund ta kuptoj pse në ndarjen e re kemi një përkeqësim të raportit të përfaqësimit në këshillat bashkiak?

Kemi këshilla, siç është rasti i Tiranës, ku numri i banorëve do të jetë mbi 10-12 mijë banorë për këshilltarë dhe në hartën që keni bërë ju, zoti Çuçi, do të keni bashki që gjithsej do të kenë 10-12 mijë banorë, do të keni raporte përfaqësimi që nga 12-13 mijë banorë, siç është Tirana, do të shkojnë në nivele 600-700 banorë për njësi klienteliste në jug të Shqipërisë, pa i përmendur me emra se i kam me listë këtu. Juve nuk e morët parasysh këtë shqetësim kur bëtë këtë hartë? A do të ishte më mirë që të kishit bërë një gjë tjetër dhe më pas të kishim bërë dhe ndarjen e përfaqësimit?

Fatmir Xhafaj – Ju lutem, zoti Çuçi! Fokusohuni vetëm te pyetja, sepse këtu secili mund të ketë orekse pafund. Pyetje, është seanca e pyetjeve dhe më pas kur të kalojmë te diskutimet, le të flasë secili sipas asaj që e çmon.

Blendi Çuçi – Për t’ju përgjigjur shumë thjeshtë, mendoj që raporti i këshilltarëve me përfaqësuesit që do të delegojnë këshilltarët, pra me popullsinë, është nga më të drejtit që është sot edhe në Europë. Sot kemi raste në Europë, për shembull, Varshava ka 1,5 milionë banorë dhe ka 55 anëtarë këshilli dhe 1 bashki tjetër e Polonisë që ka vetëm 10 mijë banorë, ka 15 këshilltarë, pra këto raporte ekzistojnë në të gjithë Europën, sepse ekziston pikërisht diversiteti i bashkive brenda një vendi të caktuar. Nuk është dhe nuk ka qenë ndonjëherë problem dhe debat kjo gjë në Këshillin e Europës, asnjëherë. Mendoj që ky është një debat i kapërcyer dhe që nuk ia vlen të bëhet këtu, aq më tepër që ne nuk kemi bërë ndryshim në këtë logjikë, pra ne kemi ruajtur logjikën që ka sot ligji, atë logjikë që ka qeverisur për 8 vjet edhe zotërinë, pra atë logjikë që ka ligji, e cila është logjikë demokratike në gjykimin tim, por besoj edhe në gjykimin e të gjithëve. Ne atë kemi ruajtur, thjesht kemi bërë që me zmadhimin e njësive krijojmë edhe një fashë tjetër, e cila nuk ekzistonte më përpara për shkak të ndarjes së re administrative-territoriale.

Kjo është përgjigjja ime. Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

A ka pyetje tjetër?

Oerd Bylykbashi – Pyetja që unë bëra pak më përpara ka lidhje me këtë të fundit. Marrim rastin e Tiranës. Qytetarët e Paskuqanit dhe të Kamzës, ku dallimi midis qytetit të Tiranës dhe i tyre territorialisht është nul, nuk kuptohet, janë njësi tjetër, ndërkohë që ata të Zallherit për interes politik i kanë sjell nëpërmjet Dajtit, sigurisht që ata do të ecin përmes Kamzës dhe i bashkohen Tiranës, por ka edhe njësi që janë akoma edhe më larg. Pra, vetëm për ta bërë atë Tiranën e madhe fare, ka njësi që janë në kufi me Elbasanin dhe janë këta njerëz, të cilët do të kenë qendër përfaqësimi Tiranën. Po kështu, është në Shkodër, ku nga Alpet në kufi me Malin e Zi do të kenë qendër njësoj si ata që janë në bregdet në Velipojë. Ju dhashë vetëm dy shembuj, që kanë lidhje me demokracinë lokale dhe me mënyrën se si do të aksesohen shërbimet. Ju vetëm me këtë ligj, ndërkohë që rrëzoni idenë se do të ketë kursim fondesh, sepse do t'i mbani shërbimet, thoni ju, a ju shqetëson ju, në kuadër të kartës së autonomisë vendore, fakti që tashmë personat që dikur zgjidheshin, do të jenë të emëruar të pushtetit të përqendruar në këto bashkitë e mëdha? Çfarë keni sjell ju për mirësim në lidhje me decentralizimin e pushtetit dhe demokratizimin në nivel vendor në këtë aspekt, përveçse është përkeqësuar? A mund të ma shpjegoni pak ndryshe?

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Po, zoti Çuçi, ju lutem!

Blendi Çuçi – Ky është një debat i kapërcyer më 31 korrik dhe i certifikuar nga Gjykata Kushtetuese në muajin dhjetor, por po sqaroj merakun që ka zoti Bylykbashi me Kartën e Autonomisë Vendore. Harta e re administrative-territoriale është e certifikuar edhe nga Këshilli i Europës dhe nga Kongresi i Autoriteteve Lokale, të cilat janë organizmat që monitorojnë pikërisht zbatimin e Kartës së Autonomisë Vendore për vendet anëtare. Mendoj që është i mbyllur si debat dhe nuk ia vlen më ta vazhdoj.

Fatmir Xhafaj – A ka pyetje të tjera? Nuk ka pyetje të tjera. Ka diskutime?

Fjalën e ka zoti Bylykbashi dhe më pas e ka fjalën zoti Klosi!

Oerd Bylykbashi – Unë mendoj që gjëja më e mirë që ishte për t'u bërë ishte ajo që ne sugjeruam në fillim, por që ju nuk e pranuat, zoti kryetar, që ne të bënim një debat të informuar mbi bazën edhe të opinionit të organeve të pushtetit vendor, organizatave të tyre, dhe të ekspertëve të Këshillit të Europës. Pa spekuluar këtu që është marrë një certifikatë nga Këshilli i Europës, nga Kongresi, sepse nuk ekziston diçka e tillë. Jo më larg se pasnesër, ose në datën 6, në mos gaboj,

do të ketë një mbledhje pikërisht të strukturave të Kongresit të Autoriteteve Lokale, i cili do të marrë në shqyrtim shqetësimet që janë në lidhje me këtë hartë, pra nuk ekziston ajo që thotë zoti Çuçi.

Jemi përpara një ligji që për rëndësinë që ka, sepse shkon dhe prek një ligj shumë të rëndësishëm, siç është ligji organik për pushtetin vendor, mbetet të pranohet që është vetëm një mballomë, janë vetëm disa tentativa për të kopsitur atë që u bë keq, për t'u dukur më pak keq seç ishte, nëpërmjet hartës territoriale. Është një ligj i cili nuk zgjidh një seri problemesh, që do të mbeten në aspektin e organizimit, thuhet që këto po bëhen për organizimin e zgjedhjeve vendore, por në fakt ende nuk janë zgjidhur problemet. Nuk mund të ndodhë as ajo që thotë zoti relator, se këto i bëjmë, sepse nuk mund të organizojmë dot ne zgjedhjet pa bërë këtë. Kodi Zgjedhor ka dispozita të tjera, të cilat janë, vazhdojnë dhe hyjnë në konflikt edhe me këtë ligj.

Për rrjedhojë, zoti Ministër po ta kishte qasur më drejt me mirëbesim, në fakt ishte me keqbesim, ai dhe Kryeministri i tij, do të kishim pasur sot zgjidhje, të cilat do t'i qëndronin kohës për 15 apo 20 vjet të tjera, por nuk e deshën këtë, sepse u intereson harta. Ky është një ligj, i cili gënjen njerëzit me këto ndryshimet që bëhen, gënjen njerëzit në lidhje me atë që ata do të presin, thjesht do të kemi një përkeqësim të marrjes së shërbimit nga qytetarët. Tashmë nuk do të jenë më qytetarët që do të kontaktojnë të zgjedhurit e tyre dhe t'u kërkojnë llogari përditë apo një herë në katër vjet, por do të kenë të emëruar personazhe të llojit sekser që kemi parë kohët e fundit, të cilët u japin shërbimet e shtetit përkundër pretendimeve që janë jo absurde, por janë skandaloze, sepse janë të emëruar. Këta administratorë që po propozohen që të vendosen në ish-bashkitë dhe komunat që sot po zhduken, do të jenë njerëz të emëruar. Të kujt? Të kryetarëve të besuar të Kryeministrit aty ku do të zgjidhen, e për rrjedhojë qytetarët do të humbasin para, nuk do të kursehen, sepse administrata do të mbetet po ajo me një person të emëruar tashmë dhe jo të zgjedhur, e për rrjedhojë ishte një gënjeshtër e madhe.

Është një ligj, i cili nuk e përmirëson, por vetëm e përkeqëson aspektin e administrimit të një sërë kompetencash të pushtetit vendor, nuk e zgjidh problemin e marrjes së kompetencës nga qeveria për mbledhjen e tatimit për biznesin e vogël, nuk e përmirëson në lidhje me kompetencat për administrimin e territorit dhe një seri kompetencash të tjera dhe me siguri, kështu siç është, prandaj thirrja për një punë pak më transparente dhe më të qetë do të na bënte punë, kështu siç është draftuar, është me plot përplasje të brendshme, të cilat gjatë zbatimit do të çojnë nesër në konflikt. Ministri thotë që po përgatisin kuadrin për të bërë një ligj kuadër bashkë me opozitën,

ndërkohë ne mund ta kishim nisur këtë dhe ta mbaronim së bashku, siç e rekomandon edhe Këshilli i Europës, siç e kërkon edhe Parlamenti European.

Jo, e gjitha është për të bërë ato ndryshime, që eventualisht do të mbeten gjatë në këtë ligj, me vullnetin e Kryeministrit vetëm që të marrë dhe të përqendrojë pushtet në duart e veta. Kryeministrit nuk i interesojnë të zgjedhurit vendorë. Me një të rënë të lapsit, nga 384 këshilla, që, gjithsesi duheshin pakësuar, i çoi në 61 këshilla. Nuk do të ketë më njerëz, që do të përgjigjen me votë përpara qytetarëve në komunat, që do të mbeten periferike, por do të ketë vetëm komisarë të dërguar atje, që do të japin shërbimin pasi të kenë kërkuar edhe preferenca seksuale.

Unë mbetem përsëri i mendimit se jemi ende në kohë që edhe pas këtij debati në parim, të thërrasim shoqatat e bashkive, të komunave dhe të qarqeve, sepse edhe ato preken; të thërrasim ekspertët e këshillit të Europës, të USAID-it, ata që kanë kontribuar, të diskutojmë dhe të shikojmë se çfarë ka nevojë për të përmirësuar ky projektligj, çfarë ka nevojë për të shtuar, sepse kështu siç e ka sjellë ministria, mendoj se ka kualitet shumë të dobët.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Zoti Klosi, urdhëroni!

Blendi Klosi – Faleminderit, kryetar!

Ligji që paraqitet sot është një ligj shumë i rëndësishëm, ku bëhet fjalë për shtyllat e shtetit. Pa dyshim, vëmendja është shumë e madhe kështu që edhe ndërhyrjet duhet të jenë shumë të kujdesshme. Bëhet fjalë për pushtetin vendor, një nga pushtetet më të rëndësishme sot në Shqipëri, që është i drejtpërdrejtë te qytetarët.

Detajet e këtij ligji, pavarësisht se është një ligj me pak nene, sjellin në vëmendje një diskutim shumë të rëndësishëm, mënyrën e funksionimit të pushtetit vendor, mënyrën e funksionimit të këshillave, përfaqësimin e tyre dhe mënyrën si këto këshilla do të ndërtohen apo edhe momente të tjera, që na bëjnë ne të kemi hapësirë në këtë diskutim.

Unë e mbështes idenë, ashtu siç e tha zoti Fino, siç kërkoi edhe zoti Bylykbashi, të kemi një seancë dëgjimore nga të gjithë faktorët që duan të shprehen për këto elemente të ligjit brenda afateve që na lejon edhe afrimi i zgjedhjeve elektorale, brenda afateve të përcaktuara nga parlamenti për të miratuar këtë ligj. Në këtë aspekt, mendoj që jemi korrektë dhe duhet t'i bëjmë këto seanca dëgjimore.

Për sa i përket asaj që folën përfaqësuesit e opozitës, ne e kemi një lajm sot për mediat dhe lajmi është dakordësia, që vjen tashmë nga opozita për ndarjen e re elektorale. Në diskutimet

e përfaqësuesve të opozitës ishte e vështirë të gjeje fjali kundër ndarjes së re elektorale, një nga kryereformat që ne kemi ndërmarrë në vend dhe që e çojnë Shqipërinë realisht një hap përpara. E them këtë, sepse në muajt e mungesës së tyre në parlament, nga 23 qershori e këtej, kemi dëgjuar dy variante dhe ndoshta kjo konfirmon edhe ekzistencën e dy opozitave sot: asaj të përfaqësuar nga lideri historik dhe asaj që do të krijojë lideri aktual, dhe prandaj edhe përfaqësuesit e opozitës e kanë të vështirë.

Shpesh thanë që nuk e njohin, e prish Shqipërinë, e ndan Shqipërinë, e çon Shqipërinë këtu, çon Shqipërinë atje dhe sot vijnë dhe e pranojnë atë. Këtë dilemë e kanë, sepse nuk dinë se si ta menaxhojnë edhe këtë situatë të caktuar.

Unë them se ky është një problem shumë i vogël në krahasim me atë që ofron reforma territoriale. Ligji i sotëm shërben ndoshta edhe për këto, që qytetarët shqiptarë të dëgjojnë konceptet dhe këndvështrimet e forcave tona politike të pozitës dhe të opozitës, për sa i përket ndarjes territoriale dhe reformës territoriale.

Do ta shikoj me shumë vëmendje, me interes dhe me angazhim personal të gjithë këtë debat, se si forcat politike do t'i përqasen dëshirës popullore për të kuptuar më shumë nga kjo reformë territoriale.

Për të hyrë në detajin kryesor, që është ai i shërbimeve, për të cilën opozita ka ngritur diskutimin, mendoj se edhe ligji i ri e shpjegon më mirë atë që ne kemi thënë, edhe kur kemi ngritur debatin tonë përpara 23 qershorit, që Shqipëria ka shumë nevojë të ketë një ndarje të re territoriale, por edhe atë që kemi thënë gjatë gjithë atij viti, ku ne kërkuam diskutimin e të gjithë faktorëve të shoqërisë shqiptare, qoftë edhe ata të cilët na monitorojnë dhe dënojnë proceset në Shqipëri, që kryefjala e reformës së re janë shërbimet karshi qytetarëve.

Edhe ndarja e re territoriale, por edhe ligji që na vjen sot këtu me krijimin e këshillave të bashkive dhe komunave, që nuk janë më këshilla të parcelizuara, por janë me përfaqësues nga të gjitha komunitetet, tregojnë edhe një herë se vëmendja për shërbimet shkon jo vetëm te qytetet e mëdha, jo vetëm te qytetet, që kanë buxhete të mëdha, por shkojnë edhe tek ato komunitete, që kanë qenë të harruara, të cilat me fondet që mbledhnin vetë, me mundësitë që kishin për të menaxhuar këto fonde, por edhe me hapësira shumë të vogla territoriale, që ata zotëronin, e kishin të pamundur të ofronin shërbime minimale për qytetarët.

Prandaj ndryshimi i madh midis dy epokave të pushtetit lokal është ky: më shumë shërbime edhe nga fondet që sigurojnë qytetet e mëdha, u shkojnë komuniteteve më problematike, dhe jo siç duan ta trajtojnë zyrtarët e opozitës.

Për sa u përket administratorëve, koncept i ri i cili paraqitet në këtë linjë, nuk është fare i ri për qytetet tona. Tirana është një shembull pak më i avancuar. Ka 11 minibashki dhe të 11-ta kanë qenë të zgjedhura nga vota e popullit, por ne kemi qytete të mëdha si: Durrësi, Vlora, Shkodra, Fieri, që kanë pasur konceptin e administratorit të emëruar nga kryetari i bashkisë dhe në asnjë rast ato nuk kanë qenë përfaqësues të interesave, por përfaqësues të komuniteteve. Nuk është e vërtetë që ata do të jenë njerëz pa përfaqësim. Ata janë njerëz të deleguar drejtpërdrejt të votës së qytetarëve të 61 të bashkive të reja, të cilat do të vijnë nga zgjedhja e drejtpërdrejtë që ata do të bëjnë për kryetarin e bashkisë dhe të komunës.

Pra, interesi i drejtpërdrejtë për qytetarët, përkujdesja për shërbimet ndaj tyre, por edhe vota që japin të gjithë qytetarët e njërive të reja territoriale, do të jetë përcaktuese edhe në emërimin e atyre që do të quhen administratorë nën këta 61 kryetarë të bashkive të mëdha.

Po e përsëris edhe një herë atë që thashë pak më parë, që lajmi i sotëm është dakordësia për ndarjen e re territoriale, megjithëse mund të fillojmë të themi që jemi dakord ose jo, por pranimi i gjerë që opinionin publik shqiptarë i bëri kësaj ndarjeje, na bën ne të vetëdijshëm, që kemi bërë një veprim shumë të mirë. Mendoj se edhe debati në vazhdim, edhe debati parlamentar kur të miratohet ky projektligj do të na japë mundësinë që përpara qytetarëve shqiptarë, forcat tona politike të paraqesin botëkuptimet e tyre për funksionimin e Shqipërisë.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

Zoti Vasili, urdhëroni!

Petrit Vasili – Faleminderit, zoti Xhafaj!

Meqenëse vijmë pas një periudhe të gjatë të mungesës së debatit në komision, sot jemi përpjekur të ndezim një debat, i cili, ndoshta, është edhe jashtë kohës dhe jashtë vendit për një pjesë të argumenteve që u folën këtu. Sigurisht, qytetarët duan të kuptojnë se cili është debati i vërtetë dhe çfarë debati na pret përpara.

Elementet e debatit që kanë të bëjnë me ndarjen territoriale- administrative janë debate të ezauruara, të cilat kanë shtrëruar të gjitha instrumentet si atë të debatit politik, por edhe atë që quhet përballje ligjore kushtetuese. Qëndrimi, që e njohim ose jo, ndarjen territoriale dhe histori

të kësaj natyre, për mua janë anakronizma, që nuk na çojnë përpara, por na kthejnë pas, pa dhënë ndonjë zgjidhje të re dhe pa vënë në lëvizje soliditetin e vendimit të marrë.

Përpara qytetarëve është një alternativë e re, alternativë e një pushteti të ndërtuar ndryshe mbi një filozofi tjetër dhe mbi një mënyrë tjetër të të kuptuarit të gjërave. Kjo pyetje e madhe e ka marrë përgjigjen.

Përgjigjja tjetër e madhe, që duan të dinë qytetarët, është që a do të funksionojë pushteti lokal i tyre. Projektligji i sotëm, me thënë të vërtetën, është një projektligj utilitar, pra, bën të mundur që në muajt që kemi përpara, të vëmë në lëvizje mekanizmin e ri të ndarjes së re territoriale. Ashtu sikurse edhe ministri tha këtu përpara komisionit (në mënyrë korrekte duke shprehur një vullnet politik dhe jo vullnetin e tij personal), se na pret një nismë gjithëpërfshirëse, pozitë-opozitë, për një ligj të kompetencave të pushtetit vendor të menduar thellë, të përshtatur sa më mirë me standardet dhe parametrat më të mirë të pushtetit vendor europian dhe në dakordësi me kongresin e autoriteteve lokale për një produkt të menduar mirë dhe afatgjatë.

Përshtatjet teknike që ligji bën dhe që shkojnë në sinkron me organizmin e zgjedhjeve, në një farë mënyre apo në një tjetër, e shterojnë debatin politik, ndonëse debati politik mund të shpiket edhe atje ku nuk ekziston. Megjithatë është një debat shterpë, nuk është në kohën dhe në vendin duhur. Ai thjesht dhe vetëm mundëson ato përshtatshmëri, që mundësojnë zgjedhje korrekte, për të cilat jemi të gjithë të interesuar që do të ndodhin në pushtetin lokal dhe të gjithë së bashku jemi të detyruar të përballemi me garën elektorale duke mos ngatërruar objektivat politike me garën elektorale, që nuk e zgjidhim ne, por qytetarët.

Ka një preokupacion në lidhje me kompetencat. Kam vënë re se ka një qasje të vazhdueshme politiko-abuzive, në lidhje me këtë çështje, është momenti të mos i hutojmë qytetarët më shumë se kaq, sepse u kemi hedhur aq shumë lumenj politikë, sa nuk mund t'i tretin dhe t'i kuptojnë më dot. Është vendi për të qenë të qartë edhe me ata, sepse edhe ata kërkojnë përgjigje të qarta. Pra, dilema është që ata që nesër do të ngarkohen të ushtrojnë pushtetin atje, qenkan të emëruar dhe është një herezi e madhe, ndërkohë që sot kemi një mekanizëm të tërë të emëruarish në pushtetin lokal, të cilët emërohen sipas vullnetit të kryetarëve të bashkive apo komunave përkatëse.

Ne kemi bashki të mëdha të vendit duke filluar nga Bashkia e Tiranës etj., që ka drejtor urbanistike dhe drejtorë të tjerë, që marrin vendime shumë të rëndësishme të territorit. Edhe këta të emëruar janë dhe pas atyre firmave, ose bëjnë gjëra shumë të mira, ose bëjnë zullume, por këta

janë të bekuarit e Perëndisë. Këta që do të vijnë nesër të emëruar do të jenë të gjithë heretikët e Perëndisë. Besoj se këto dy lloj standardesh, që nga ana botëkuptimore janë të mbushur dhe të mbarsur me paragjykime, nuk na çojnë përpara, por na çojnë në një logjikë, që lëviz nëpërmjet parametrave, që shkojnë nga kafeneja te pijetorja, por as njëri dhe as tjetri parametër nuk është i dobishëm.

Njerëzit e zgjedhur me votën e popullit kanë edhe autoritetin të emërojnë vartësit e tyre dhe ky mekanizëm emërimi nuk ka pse të afektohet politikisht. Besimi në popull u jep mundësi atyre të ecin dhe vlerësimin e marrin po nga populli. Nuk e marrin nga ne, sepse bashkitë nuk kemi pse t'i ndajmë në të majtë apo në të djathtë, por në bashki që të funksionojnë dhe të jenë eficiente dhe t'u japin qytetarëve atë që duan. Përqindja e mosfunksionimit apo e mirëfunksionimit nuk është e lidhur politikisht, por është mënyra se si administrohet dhe me çfarë korrekte e ka pushtetin.

Ndaj unë them se është e dobishme që në nismën e ardhshme (besoj se do ta përgatisim së bashku) të përdorim me korrektesë marrëveshjen përkatëse, që në të ardhmen të mos themi që ajo marrëveshje ishte e padobishme. Pra, të bëjmë një marrëveshje vërtet efektive dhe të mos e përdorim vend e pa vend, sepse nuk ka qenë as kjo fryma e marrëveshjes.

Frymë e marrëveshjes do të thotë që në një nismë të madhe për një ligj të ri të pushtetit vendor, të gjithë së bashku me dakordësi të plotë, me mirëkuptim dhe me të gjitha mekanizmat e kontrollit reciprok politik, ta çojmë përpara.

Prandaj në lidhje me këtë çështje mendoj se duhet të jemi të përmbledhur dhe të përmbajtur në përdorimin e saj, në mënyrë që edhe publiku ta kuptojë që një çështje e caktuar është zgjidhur në frymën e marrëveshjes, ta kuptojë që dakordësia pozitive-opozitive ka ardhur, sepse çështja është madhore. Nuk është marrëveshja që na ndryshon pozicionet, që maxhorancën e bën opozitive dhe opozitën e bën maxhorancë. Kush ka një iluzion të tillë ka gabuar vendin.

Edhe në çështjen e sotme e ngatërruam kot këtë çështje. Është mjaft e qartë. Cilido që merret me legjislacion e shikon që përshtatshmëritë janë thjeshtësisht të karakterit teknik dhe adaptojnë një situatë të re. Pra, në ligjin e mëparshëm ne kemi pasur komuna dhe nuk kemi më; kemi pasur edhe disa mekanizma të tjerë, që përshtatin sistemin, por përqsja tjetër e madhe do të jetë në atë nismë, që do të bëjmë për rishikimin total të pushtetit vendor.

Pas ardhjes së opozitës është kjo mundësi reale. Ka edhe një frymë politike që u formësua në marrëveshje, që është argumenti i dytë thelbësor, dhe i treti: hajde të prodhojmë produkt, i cili

rrëfen vërtet që kjo marrëveshje, pozitë-opozitë, ka qenë edhe e menduar mirë, ka qenë edhe e sinqertë, por nuk ka qenë takticizëm politik që njëra palë të fitojë kohë, t'i japë fuqi vetes, në mënyrë që të kuotohet më mirë në tregun politik për të nesërmen e asaj politike.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Vasili!

Zoti Peza, urdhëroni!

Dashamir Peza – Zoti Fino, për të cilin kam shumë dashuri, më propozoi të flas shkurt. Me thënë të drejtën nuk kisha ndërmend të flisja sot, por kështu si u zhvilluan ngjarjet këtu, nuk mund të rrija pa ndërhyrë.

Historia se si zhvillohet komisioni këtu, është kthyer në daç quajeni *deja vu*, ose *je me vu*, por këtu ka mbetur të vijë zoti Çuçi dhe të vërë një fotografi të hartës atje dhe zoti Bylykbashi të thotë: po, e mbaj mend këtë hartë. Duhet të ishim atje, por nuk shkuam 6 muaj, sepse donim ta shtynim 6 muaj më tutje e gjëra të tjera.

Pse e them këtë? Sepse nuk po e kupton Bylykbashi. Përpara se të fillonim mbledhjen e komisionit, kanë shkruar këtu: “sugjerimin ta shtyjë, qasjet të jenë të matura dhe të pjekura”. Këtë propozim e dija përpara se të fillonte mbledhja e komisionit: “ta shtyjë, të mblidhemi me Këshillin e Europës, të mblidhemi edhe me disa specialistë, pastaj të mblidhemi edhe me disa të tjerë dhe ta shtyjë për më tutje historinë e diskutimit të ligjit”.

Ka kaluar një vit e gjysmë që na propozohet ta shtyjë votimin e ligjeve në parlament, sepse do të krijohet një komision i ri i përbashkët (kjo shprehja më pëlqen shumë), ku minoranca të ketë të drejtën e vetos.

Çfarë propozohet? Propozohet që të mos ketë parlament, por, ku di unë, të krijohet një komision *ad hoc* dhe të ulemi të gjithë së bashku. Më kujtohet që kur ishim në opozitë na thoshit: “Doni të dekapitoni parlamentin”, - e mbani mend besoj, zoti kryetar. Çfarë po propozojmë? Po propozojmë që: “Hajde të ulemi bashkërisht dhe të bëjmë një diskutim racional, ashtu siç do t'i kishte hije parlamentit”. Kemi një vit e gjysmë, unë personalisht kam një vit e gjysmë që mezi por pres të propozoj ndonjë gjë opozita që të bie dakord me të. Kam një vit e gjysmë! Sinqerisht, më është kthyer në një lloj makthi, sepse mendoj se pas 100 viteve apo 200 viteve punët në Shqipëri do të jenë më mirë, do të caktohet një grup njerëzish që do të shikojnë procesverbalet tona dhe, po ju them sinqerisht, do të jetë hera e parë dhe besoj edhe hera e fundit që për një vit e gjysmë opozita nuk ka propozuar asgjë. Asgjë! Asnjë korrektim!

Kemi qëndruar 4 vjet në opozitë, (unë kam qenë 4 vjet, të tjerët kanë qenë 8 vjet), kemi ardhur këtu dhe kemi bërë propozimet tona, të cilat janë kundërshtuar, për disa gjëra jemi marrë vesh. Ka pasur një mënyrë diskutimi.

Çfarë po ndodh sot? I vetmi propozim është ta shtyjmë, të mblidhet komiteti *ad hoc* dhe ta zgjidhë jashtë parlamentit.

Zotëri, unë personalisht e kam votuar rezolutën. E kam votuar me gjithë shpirt e zemër sepse ka gjëra për të cilat duhet të merremi vesh, por rezolutën nuk e ndërtuam si mur që të mos vazhdojmë me asnjë lloj pune në parlament dhe për çdo gjë të themi ta shtyjmë për më vonë.

Çfarë ndryshimesh ka këtu? Ka ndryshime thelbësore, të cilat vënë në eficiencë dhe e bëjnë funksionale nga pikëpamja praktike një vendim, që tashmë është marrë, ku kemi rënë dakord të gjithë që duhet të vazhdojmë në atë rrugë.

Zoti kryetar, dua të falenderoj sinqerisht edhe ministrin, edhe Bashkimin për vullnetin e treguar për të shtyrë përpara një diskutim serioz dhe të përbashkët me opozitën për çështjen e ligjit për decentralizimin, dhe të gjitha ligjet e tjera që synojnë ta çojnë pushtetin sa më afër qytetarit.

E ftoj me shumë dashamirësi dhe mirësi opozitën të bëhet pjesë e diskutimeve dhe propozimeve në komision, sepse mezi po pres të bëhem një herë me ata dhe të dal në opozitë me grupin tim, por nuk po më jepet mundësia. Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Peza!

Zoti Halimi, urdhëroni!

Eduard Halimi – Ky projektligj dhe ky diskutim i sotëm nxjerrin në pah dy probleme të mëdha që kemi ne në oborrin e politikës.

E para, është arroganca e madhe dhe arbitrariteti që kemi kur jemi në pushtet dhe kur fitojmë zgjedhjet; sillemi si sundues për t'i marrë dhe për t'i pasur të gjitha për vete, duke lënë mënjanë tolerancën dhe atë që është fundamentale, shërbimin ndaj qytetarëve.

E dyta, është hipokrizia politike, e cila kalon edhe në satirë, sa qesh e gjithë salla këtu dhe ata që na dëgjojnë atje mbrapa.

Në diskutimin e sotëm ka një gjë të vërtetë. Ky ligj vjen bashkë me ligjin “Për reformën territoriale”, dhe në fakt ishte një mundësi që ju si maxhorancë t’u thoni qytetarëve se këta të anës këtej e kanë gabim. Harta territoriale nuk ka qenë klienteliste, por ka qenë në shërbim të qytetarëve. Ka qenë në funksion të decentralizimit. Ja ku e keni, hapini sytë! Këta këtej po ju mashtrojnë! Po ja ku erdhi. 7 muaj dhe nuk i dolën asnjë ditë për të shkruar një rresht të vetëm për decentralizimin.

Një rresht të vetëm për të mirën e qytetarëve. Ndaj të dyja bashkë mbeten, zoti Klosi, klientelistë dhe në të kundërt të të mirës së qytetarëve shqiptarë. Mbeten klientelistë, i shërbejnë partisë politike dhe partive politike madje, maxhorancës, por nuk u shërbejnë qytetarëve. I shërbejnë funksionit për të pasur një Kryeministër që të sundojë oligarkët më të mëdhenj të bashkive, por nuk u shërbejnë qytetarëve; i shërbejnë këtij modeli që kemi sot ne, që Fieri përmytet dhe njerëzit vuajnë për bukën e gojës. Ndërsa në Durrës mbillen 360 palma nga 6 mijë euro secila; i shërbejnë këtij modeli, e çimentojnë këtë model, por nuk na çojnë më tek ai modeli për të mirën e qytetarëve.

Sot qytetarët donin të dëgjonin që ne e kishim gabim, që pas miratimit të kësaj harte, nga ana e maxhorancës, vinte edhe një projektligj i ri, i cili nuk do të ishte Kryeministri, që do t'i kishte të gjitha për vete si fitues i zgjedhjeve, por do të jepte diçka, do të tregohej tolerant. Do t'i jepte edhe pushtetit vendor, nuk do t'i administronte fondet e ca të nënës dhe ca të njerëzës, ca të vdesin për bukë dhe ca të kenë 40% furnizim me ujë, dhe 60% të tjerë të kenë ujë me orar dhe disa të tjerë të mbjellin palma më shumë se sa mbillen në Nicë apo në vendet me zhvillim turizmin shumë herë më të lartë se ky yni.

Ky ishte një shans që t'ua thoshit ju qytetarëve, sepse ju e keni qeverinë, ju jepni llogarinë përpara qytetarëve, ne jemi opozitarët e vendit. Ne kritika do të bëjmë. Ju duhet t'ua thoshit qytetarëve që ky projektligj bashkë me hartën do të ishte një mundësi që do t'i hiqte Kryeministrit kompetencën për të pezulluar lejet e ndërtimit në mënyrë selektive; do t'i hiqte mundësi Kryeministrit të bllokonte projektet në ato bashki ku ka kundërshtarin politik, por nuk e bëtë këtë gjë.

Erdhët me një projektligj, që nuk thotë asgjë për cedimin e kompetencave, sepse i do Kryeministri për vete. Të mos jemi hipokritë me qytetarët! Të mos u themi që nuk patëm kohë 7 muaj për të hartuar dy rreshta për decentralizimin, por t'ua themi troç qytetarëve shqiptarë: “Kryeministri i do të gjitha për vete. E bëri hartën klienteliste dhe po e bën këtë ligj për t'i pasur përsëri të gjitha kompetencat, për të mos ceduar asnjë rresht nga kompetencat që ka për bllokimin e projekteve për ndarjen e fondeve në mënyrë selektive; për prishjen e ndërtimeve në mënyrë selektive; për t'i shërbyer një pushteti selektiv dhe arbitrar. Kjo është e vërteta.

Ky është qëndrimi koherent i opozitës dhe ja, erdhi ora që hipokrizisë, pas 7 muajsh, t'i vinte fundi. Ky është ligji, i cili nxjerr zbuluar hipokrizinë e radhës së qeverisë së bashku me hartën territoriale. Harta dhe ky ligj mbeten tërësisht klienteliste dhe jo në shërbim të qytetarëve. Do të jenë qytetarët, ata që më 21 qershor do t'i japin përgjigje të gjithë pushtetit arbitrar, sepse pushteti

arbitrar dhe arroganca, e kam thënë shpesh, e ka një fund, jo nga opozita, por nga qytetarët. Nuk është as rasti i parë dhe as i fundit. Opozita këtë detyrë ka, do të kritikojë; do të bëjë transparencë për qytetarët, siç e bëri sot dhe do ta vazhdojë ta bëjë edhe më pas. Në fund, qytetarët shqiptarë do t'i drejtohen kundër çdo pushteti arbitrar me votë. Faleminderit!

(Blendi Klosi kërkon të marrë fjalën.)

Fatmir Xhafaj - Jo, nuk e prish rregullin! Ju lutem asnjë fjali!

Blendi Klosi – Vetëm një fjali dua të them!

Fatmir Xhafaj – Ju lutem! Do të mbaj një standard për të dyja palët!

(Zoti Klosi flet pa mikrofon.)

Ju lutem! Nuk ka replikë këtu! Në parlament bëj replikë. Këtu jo. Në qoftë se do të bërtasësh edhe ti, bërtit, por me të drejtë nuk ta jap fjalën! Nuk ka rëndësi se të përmendi ty. Nuk të përmendi ty, personalisht! Ai përmendi...Ai iu referua diskutimit tënd, zotëri!

(Zoti Klosi flet pa mikrofon.)

Nuk do të bëni diskutim! Folët!

(Diskutime pa mikrofon.)

Ju lutem, ka një rregull një standard për të gjithë!

Zoti Klosi, ju lutem! Në fund, mund të flisni!

(Diskutime pa mikrofon)

(Zoti Klosi kërkon fjalën.)

Zoti Klosi, nuk ju lë, më vjen keq!

Blendi Klosi – Dua të bëj një ndërhyrje. E kam për procedurë.

Fatmir Xhafaj – Dakord për procedurë.

Blendi Klosi – Zoti Xhafaj, meqenëse këtu u përmendën palmat e Durrësit, ku ka pasur debate të forta parlamentare, e ka përmendur edhe Saliu, e përmendi edhe zoti Halimi, dua të them, që të jeni të sigurt, zotërinj opozitarë, se Fieri nuk është përmbatur nga palmat e Durrësit. Fieri është përmbatur nga politika juaj rrumpallë që bëtë 8 vjet apo, nëse do, edhe më shumë se kaq. Nuk latë një pemë të mbjellë në territorin shqiptar.

Fieri dhe Vlora u përmbytën, Vjosa doli nga shtrati, sepse ndërtimet pa leje mbi kolektor, ndërtimet pa leje që ju miratuat kur ishit në pushtet, qoftë edhe në fund të funksionimit tuaj, bëtë që territori i Shqipërisë të ishte krejtësisht i pambrojtur, dhe natyra të reagoonte.

Fieri nuk u përmyt nga palmat e Durrësit, por ato ju verbojnë ju, edhe nga gara e ardhshme elektorale dhe kjo që po bëni këtu sot, ka të bëjë me territorin, me qytetarët.

Ky diskutim që po bëjmë ne sot duhet të lidhet me dëshirat karshi qytetarëve, dhe jo me interesat personale të njërit apo tjetrit.

Fatmir Xhafaj - Zoti Manja,

Fatmir Xhafaj - (*ndërhyrje për z. Klosi*) e ke absolutisht gabim, dhe këtë ta them sinqerisht edhe si koleg dhe si të duash ti, e ke shumë gabim që ndërhyn.

Ulsi Manja - Faleminderit! Unë do të flas jashtëzakonisht shumë shkurt. Nga i gjithë ky diskutim që u bë këtu konstatoj dy gjëra:

E para, opozita është bërë pishman që nuk ishte pjesë e komisionit për reformën territoriale, por e pranon reformën dhe ka hequr dorë nga teoria e “patkoit”, dhe është kthyer te teoria që në fillim duhet te ligji për reformën territoriale dhe pastaj këto të tjerat që i kërkon sot.

E dyta, sado që opozita sot përpiqet të hedh baltë mbi reformën territoriale, komisioni Fino dhe kjo maxhorancë ka meritën e madhe, dhe shkëlqimi i kësaj reforme nuk mund të zbehet, sepse ju ka hequr shqiptarëve nga shpina plot 322 bajraktarë.

Nëse kanë qenë 383 njësi vendore sot kemi 61 bashki, dhe ju ka hequr nga shpina 322 njerëz, që merrnin besimin dhe votat e qytetarëve, dhe që të gjithë banonin në Tiranë me vulat e komunave dhe bashkive në çantë, dhe qytetarët, ata për të cilët opozita sot qahet, dhe është qarë në dinamikë se do të ngelin pa shërbime, vinin nga ana anës në Tiranë për të marrë vulën e kryetarit të komunës ose të bashkisë për një certifikatë ose për një vërtetim që i duhet për ndihmën ekonomike.

Ndërsa sot, ne si maxhorancë, që besojmë fuqishëm te vota e popullit dhe jo te hartat, sepse ky është ndryshimi i madh mes nesh dhe i kolegëve përballë, duke besuar te votat e qytetarëve, i kemi dhënë mundësinë të zgjedhin ndër 61 burrat dhe gratë, më të mirët, për të cilët ata do shprehen më datën 21 qershor.

Këtyre të tjerave pastaj, me përmytje, me varfëri, dhe të tjera gjëra në emër të qytetarëve, tashmë u ka dalë boja, se 8 vjet ishin në pushtet dhe e pamë shumë mirë se sa ju dhimbeshin qytetarët, përmytjet, e të tjera.

I dimë përmytjet në Veri të Shqipërisë, edhe sot e kësaj dite asnjë qytetar në Shkodër, që u përmyt, nuk ka marrë asnjë qindarkë, për të mos folur pastaj për zonën time, Dibrën, për

Bulqizën, Klosin dhe Burrelin, ku dihen pasojat e qeverisjes 8-vjeçare të kolegëve përballë. Unë kaq kisha. Faleminderit!

Fatmir Xhafaj - Faleminderit! Zoti Strazimiri, dhe mbyllim më pas diskutimin me zotin Fino.

Gent Stazimiri - Faleminderit, zoti kryetar!

Ky u bë pak ligj i përzier me palma, Vjosë e poshtë, bile Shkumbin e poshtë, Fieri, Vlora e gjithë çfarë i sheh sot nën ujë, herën e fundit që janë administruar nga PD-ja ka qenë korriku i vitit 1992.

Nëse janë prerë pemë dhe nëse janë shkatërruar lumenj, shihni se i keni në mes vetes se ata kanë qenë administratorët, që po i hiqni tani sikur paskan qenë bajraktarë.

Çfarë do lexojnë njerëzit në procesverbalet mbas 100 apo 200 vjetëve? Atë që lexojnë sot, që për tre vjet u pritëm për tre ligje, duke ju lutur dhe duke ju thënë t'i votojmë në seancë plenare, sepse i kemi bërë bashkë, është produkt konsensual, tre vjet nuk i votuat, tre vjet rresht Sali Berisha iu tha: “bëjini ju një herë nga e para, sillini si të doni, se do t'i votojmë”, tre vjet rresht thatë jo, tre vjet rresht shans i humbur për të qenë me anën tjetër, pozitë apo opozitë nuk ka rëndësi.

Në qoftë se kemi kërkuar këtë shans, kolegë, e bënit këtë punë, por e thonit jo vetëm që të mos merrnim statusin, dhe pastaj në një ditë të bukur po ato ligje të përgatitura në mënyrë konsensuale u mbledh parlamenti jashtë radhe, pasi ishim të shpërndarë në fushata, na thanë ejani se ndërroi mendje PS-ja do t'i votojmë dhe i votuam. I votuam dhe çfarë bëmë herën tjetër sapo u mbledhëm?

Akti normativ nr. 2, se i pari ishte ajo që të mos hapin gojën ministrat “kodi i heshtjes”, të bllokohen këto produkte konsensuale që kishim bërë bashkë në herën fundit që ishim takuar në mbledhjen jashtë radhe, duke prishur konsensusin me palën tjetër, ligje shumë të rëndësishme, ligje kërcell të domosdoshme për statusin, i bllokuat me akte normative, i ndryshuat dhe vazhdoni t'i ndryshoni edhe sot pa hyrë ende në fuqi. Këtë do të lexojnë njerëzit edhe pas 100 apo 200 vjetësh, se këtu janë.

Nuk keni nevojë për opozitën. Nuk mendoni se për të mirën e popullit keni bërë ca hesape elektorale është e qartë kjo, nuk keni pyetur opinionin publik që mbas Kushtetutës pyetet me referendum. Nuk është bërë një gjë e tillë dhe bëtë namin që të hidhej poshtë. Keni pyetur Gjykatën Kushtetuese e cila pret reformën, sigurisht jo konsensuale, nuk e pret nga ministri apo nga relatori

siç thotë zoti Peza, e pret nga ministri i pushtetit lokal dhe nga zoti Fino rregullimin e këtij ligji. Jo.

Njësoj si ky ligj edhe gjyqësorin e pret reforma nga Kryeministri, asnjëri nga ju nuk di gjë, njoftoheni me sms në sekondën e fundit, bile edhe ai bën sikur nuk di gjë, sikur ka dalë një propozim nga poshtë, dhe sigurisht që përfitojnë ata që janë lart.

A është më mirë për njerëzit nga Sllova, Lekbibaj, Dukagjini, apo nga Salaria, të bëjnë gjithë atë rrugë për të gjetur këtë, që nuk do të vij në Tiranë, por do të banoj në Tepelenë, Peshkopi, apo në Shkodër, iu bie më mirë, këtë do ta shohim më 21 qershor.

Më 21 qershor do të pyetet opinionin publik, me 21 qershor do t'u bimbë dyerve, siç u ratë me 23 qershor të 2013-s, kur bëtë ca premtime dhe nuk mbajtët asnjë për mendimin tim, por atë do ta shohim, do t'ju hapin apo jo derën shqiptarët.

Më 21 qershor do të jetë dita ku do të provojmë se kush është bërë pishman, dhe kush do bëhet pishman, më 21 qershor dhe jo mbas 100 apo 200 vjetësh, këtë tekst që themi këtu sot secili prej nesh, do të na e nxjerrin para syve secili prej atyre, që do të shkojmë t'i kërkojmë votën. Do të na e nxjerrin para syve, dhe nuk do të bëjmë dot sikur nuk dëgjojmë sepse nuk e mban dot telefonin në dorë, por je i detyruar t'i shohësh në sy. Faleminderit !

Fatmir Xhafaj – Faleminderit dhe i mbyllim këtu diskutimet me zoti Fino si relator.

Bashkim Fino - Zoti kryetar, faleminderit!

Natyrisht nuk e prisja një seancë komisioni kaq të gjatë për një projektligj kaq të thjeshtë teknik, siç u tha edhe nga zoti Bylykbashi edhe zoti ministër.

Është një ligj tërësisht teknik në kuadrin e zgjedhjeve të 21 qershorit, dhe me çfarë dëgjova nga kolegët e opozitës mezi e presin për të na shembur, për të shkuar shtëpi më shtëpi, dhe madje disa prej tyre po prapë nga opozita, patën frikë nga këto zgjedhje, dhe unë nuk e di tani se cilat të marr për bazë, por gjithsesi do të vazhdoj më tej diskutimin tim.

Mendova se sot opozita do të vinte të thoshte: “Në rregull, ta miratojmë këtë projektligj, por kur do vij ligji i decentralizimit, ligji thelbësor i decentralizimit?”, që as këtë pyetje nuk e bën, dhe ma lejuan mua ta bëj këtë pyetje, madje të thoshin: “Në rregull, jemi dakord me këtë projektligj”, por siç ka thënë udhëheqësi ynë Lulzim Basha këtu e shtatë – tetë muajve më parë: “Ne e duam reformën territoriale, por duam në fillim decentralizimin”, prandaj edhe sot këta do t'ju pyesin se kur do vij ky decentralizim?.

Po të shikosh, këtu nuk ka as arrogancë të madhe kur je në pushtet, që thotë zoti Halimi, dhe as hipokrizi politike, që kalon edhe ca të tjerë, që thotë po prapë zoti Halimi. Arroganca dhe hipokrizia më e madhe është juaja zotërinj opozitar.

Unë jam krenar sot që flas për reformën, për këtë projektligj dhe për decentralizimin. Më lejoni t'ju them dhe e kam të bazuar me fakte. Ju për shtatë muaj po na tregoni që nuk keni bërë asgjë për decentralizimin. Po, është e vërtetë që nuk kemi bërë asgjë, se u morëm me ndarjen territoriale. Po ju që ishit në pushtet për tetë vjet, çfarë bëtë për decentralizimin? Asgjë. Atëherë mos na tregoni arrogancën dhe hipokrizinë.

Zotërinj opozitarë, po ju them një gjë, sot ky Kryeministër që drejton, a drejton me ato ligje, me ato vendime, me atë ligj të decentralizimit që ka drejtuar edhe Sali Berisha për tetë vjet në pushtet? Pse atëherë ai kishte pak kompetenca, dhe sot Edi Rama paska më shumë kompetenca, dhe se i paska marrë më shumë kompetenca pushtetit vendor? Jo, është e njëjta gjë, madje jemi ne socialistët, progresistët, që kemi kërkuar gjithmonë dhe e kam thënë historikisht dhe do ta them gjithmonë, e majta di të bëjë reforma. Bëmë reformën territoriale, do të bëjmë edhe reformën e decentralizimit, doni apo nuk doni ju, por duam që edhe ju të jeni bashkë me ne, ta bëjmë bashkërisht këtë reformë të decentralizimit.

Ne nuk duam të shfrytëzojmë 84 votat, por duam ta bëjmë me konsensus bashkë me ju, ashtu siç bëmë në vitin 2000 ligjin për reformën dhe decentralizimin.

Ju sot na vutë përpara një diskutimi politik dhe thoni: “Jo, ne nuk duam ta bëjmë”, edhe për një projektligj që është tërësisht teknik. Çfarë thotë projektligji? Projektligji thotë: “doni apo nuk doni ju, ndarja territoriale u bë fakt.

Opozita e ka pranuar një gjë të tillë, madje jo vetëm e ka pranuar, por në lajme e kam dëgjuar dhe a pardje që ju ka angazhuar ju deputetëve, që keni ngrënë një milion shuplaka të shqiptarëve, që të jeni në krye të fushatës. Pra, ka pranuar të veni në zgjedhje, por ka pranuar sepse u bë fakt i kryer edhe me vendim të Gjykatës Kushtetuese. Kur e ka pranuar, atëherë zoti Bylykbashi, pse keni frikë të shkoni në zgjedhje?. Ti po më thua që kryetarët e bashkisë do emërohen, që PD-ja do humbasë, po ky nuk është fati im.

Po të humbasë PD-ja dhe po të fitojë PS-ja 61 kryetarë bashkie, hallall na qoftë ne, po kryetari i bashkisë do dalë nga zgjedhjet e 21 qershorit, nga zgjedhjet që ju na treguat, do bëhen zgjedhje.

Në qoftë se një kryetar bashkie nesër do të jetë i PD-së nesër, do të ketë të njëjtën kompetencë si ai kryetari i bashkisë së PS-së, që do të thotë se edhe ai kryetari i bashkisë i PD-së do t'i emërojë këta administratorët në njësitë përkatëse.

Po pse këta të PD-së kur t'i emërojnë janë të mirë, dhe këta të PS-së nuk janë të mirë. Ligji është njësoj për të gjithë, ndaj mos keni frikë nga zgjedhjet dhe ejani ta miratojmë këtë projektligj, që është tërësisht teknik. Është teknik sepse ka të bëjë me këshillat e bashkive, me numrin e këshilltarëve të bashkisë, me numrin e këshilltarëve të qarqeve në nivel të dytë, është teknik se ka të bëjë edhe me kompetencën që kryetari i bashkisë të miratojë organigramën e strukturës së vet. Është njësoj sikur parlamenti të miratonte organigramën e strukturës së një ministrie, dhe ne të themi tani që kryetari i bashkisë ta miratojë vetë organigramën e strukturës së një bashkie përkatëse.

Këto janë pesë ndryshime, që bëhen në këtë projektligj, dhe këtë e them për publikun, nuk e them për ju se ju e dini shumë mirë këtë gjë. Pra janë pesë ndryshime tërësisht teknike, dhe pse i bëjmë këto ndryshime të dashur qytetarë? I bëjmë sepse duam që ligjin e ri të decentralizimit nr.8652, kur ta prekim në themel, se do preket tamam në themel, ta prekim bashkë me opozitën.

Pavarësisht se i kemi 84 vota, ne decentralizimin do ta bëjmë edhe në qoftë se këta nuk do bëhen pjesë, edhe në qoftë se do na bëhen pengesë, ne do ta bëjmë.

Tani përpara se të vijmë te zgjedhjet, se erdhën zgjedhjet, jemi në muajin shkurt, dhe po vijmë zgjedhjet e qershorit, ne nuk mund të bëjmë paralelisht urgjencë, dhe këtë gjë ia kemi thënë me kohë Lulzim Bashës, ia kemi thënë bashkë me Petrit Vasilin kur kanë qenë të dy bashkë në një Kuvend të kryetarit të bashkive dhe komunave të Partisë Demokratike, si dy persona që ishin në Komisionin e Reformës Territoriale. Morën pjesë atje bashkë me kryetarët dhe me Lulzim Bashën, dhe folëm hapur, dhe mendova se do gjenim gjuhën e përbashkët për të qënë prezent në reformën territoriale, dhe ç'na konkludoi pas 3-4 ditëve?. Na konkludoi qëndrimi që Lulzim Basha thotë: “dua një herë decentralizim, pastaj hartën territoriale”, ndërkohë që këtu e argumentoi shumë mirë edhe ministri, është bërë tani fakt i kryer, është miratuar harta territoriale, është dhënë vendimi përfundimtar edhe nga Gjykata Kushtetuese, dhe sot jemi përpara zgjedhjeve të 21 qershorit. Para zgjedhjeve ne nuk mund të bëjmë me shpejtësi të madhe ndryshimin e ligjit të decentralizimit nr.8652. Nuk mund ta bëjmë dot, se nuk ia falim vetes për të bërë gabime.

Një ligj preket që të jetë jetëgjatë 10-15 vjet, ashtu siç është edhe ligji aktual, që është bërë në vitin 2000 dhe sot jemi në vitin 2015, pra 15 vjet, dhe është një nga ligjet më të mirë që vlerësuar nga Këshilli i Evropës dhe nga Karta e Autonomisë Vendore.

Ne duhet të bëjmë një ligj për decentralizimin, të kujdesshëm, të mirëkuptueshëm, me të gjithë aktorët që kanë interes për këtë gjë, me gjithë OJQ-të përkatëse, me USAID-in që na asiston, me faktorin ndërkombëtar, me opozitën, që të marrim sa më shumë kompetenca për pushtetin lokal, dhe për të qenë sa më afër shërbimit të qytetarëve. Kjo gjë kërkon kohën e vet, sepse duhet të ulesh, të diskutosh, të trajtosh gjërat, dhe të arrish në konkluzion dhe konkluzioni për të mbajtur me konsensus kompetencat që ne do të marrim në këto momente. Prandaj po themi që sot opozita të thoshte: “dakord, faleminderit, ta kalojmë këtë ligj, ka të bëjë me çështje teknike dhe çështjet teknike duhet t’i miratojmë”, se do apo nuk do opozita, pavarësisht se ne kemi 84 vota, do ta bëjmë këtë punë se kemi 61 bashki dhe 61 këshilla bashkiakë, dhe këtë gjë duhet ta bëjmë patjetër, ta miratojmë ligjin dhe të thoshin: “dakord, por duhet të dimë se kur do të bëhet decentralizimi?”, dhe ky është thelbi i kësaj çështje.

Ne i kemi kërkuar edhe kryeministrit tonë, dhe në qoftë se ka oponencë më të fortë, paskëshim qenë ne socialistët vetë, dhe jo ju, sepse ne i kërkojmë çdo ditë ministrit, kryeministrit që të na sjellë përpara sa më shpejt ligjin e decentralizimit, që të jemi sa më afër qytetarëve me shërbimet përkatëse. Këtë e kërkojmë patjetër, dhe ministri bashkë me kryeministrin na kanë thënë: “dakord, do e bëjmë”, por që të bëhet më efektiv si mund të bëhet?

Unë e mendoj kështu, se vij nga klasa politike e pushtetarëve lokal, kam qenë kryetar bashkie, kam qenë ministër i pushtetit lokal, dhe e di shumë mirë këtë gjë, dhe pres që të marr mendime fantastike nga kryetarët e rinj të bashkive kushdo qofshin ata, dhe nga këshilltarët përkatës.

Nuk mund të marr mendimin nga këta që janë, se këta ma japin mendimin, por ka konflikt interesi, kurse ata që vijnë janë të rinj dhe kanë të gjithë mundësinë e nevojshme për të dhënë mendime, sugjerime, se si mund të bëhet decentralizimi, nga aktorët e interesit tjetër po e po.

Të bëjmë një ligj përsëmbari, që t’i shërbejë dhe të jetë sa më shumë afatgjatë, prandaj unë mendoj, që, në qoftë se ka fushë ku ne socialistët duhet të krenohemi, është fusha e decentralizimit të pushtetit vendor, që kemi bërë jashtëzakonisht shumë për pushtetin lokal, dhe është një nga fushat më kryesore që historikisht nuk ka bërë asgjë e djathta dhe PD – ja në 8 vjet pushtet.

Ne mendojmë sot që ky projektligj, që është sa më teknik aq edhe i thjeshtë, nuk e mendoja kurrë që do bënte një rezistencë të gjatë politike, por siç e tha edhe kolegu ynë këtu, me sa duket, ju jeni bërë pishman për hir të së vërtetës, dhe duhet të jeni bërë vërtet pishman, që nuk morët pjesë në Komisionin e Reformës Territoriale, dhe shumë keni bërë që sot një pjesë e diskutimeve përkatëse, madje mund të them 90% e diskutimeve kishte të bënte me ndarjen e hartës territoriale.

Pra, le të themi se janë diskutime të munguara në kohë, që duhet t'i bënit këtu e një vit më parë, por prapë fajin ju e keni, se ju pritëm gjatë zotërinj opozitarë.

E nisëm me Komisionin e Reformës Territoriale në janar të 2014-ës, dhe nuk na erdhët për 2-3 muaj. E vazhduam dhe e bëmë komisionin përsëri, dhe nuk na erdhët, dhe bitisëm ta mbarojmë vetë Komisionin e Reformës Territoriale, dhe prapë ishim të hapur dhe prapë me zotin Vasili ju erdhëm në Kuvendin tuaj të kryetarit të bashkive e të komunave të PD-së, dhe përsëri këmbëngulët si mushka jo dhe jo, që nuk do ta bënit, dhe në fund të fundit u mor edhe vendimi i Gjykatë Kushtetuese, atëherë çfarë keni?

Jeni të detyruar të respektoni siç keni thënë vendimet e Gjykatës Kushtetuese, jeni të detyruar të respektoni votën e popullit të 84 deputetëve atje.

Meqenëse jeni të detyruar ta respektoni, respektojeni dhe ejani këtu të bëjmë bashkërisht me konsensus një proces konsensual. Doni të bëjmë proces konsensual edhe për këtë ligj që është teknik? Ejani ta bëjmë, jam i hapur. Ia bëra propozimin kryetarit në fillim, po e ribëj edhe një herë zoti Kryetar.

Jam gati të ribëhet edhe një herë një proces konsensual për këtë projektligj që ka pesë nene teknik, por nëse do opozita jam plotësisht dakord ejani ta bëjmë. Të thërrasim edhe aktorët e interesit, OJQ-në, Këshillin e Evropës, USAID-in, kë të duan ata, të bëjnë edhe propozim konkret se kë duan dhe ejani të bëjmë një proces konsensual dhe për këtë projektligj.

Ta bëjmë dhe në frymën e këtij procesi konsensual të këtij projektligji meqë sot e kaluam në parim, ejani të vazhdojmë edhe për ligjin e ri kur të na vijë, siç tha edhe ministri të decentralizimit të pushtetit vendor.

Pra, nuk ia vlente të zgjatesha unë në diskutim, nuk ia vlente të flisnin të gjithë diskutantët që folën këtu, sepse është një ligj tërësisht për pjesën teknike, por e mbyll kryetar, duke kërkuar edhe një herë mirëkuptimin e opozitës, pa dashur të shfrytëzoj forcën e 84 votave që kam në parlament. Të bëjmë një proces konsensual absolutisht edhe për këto pesë nene me aktorët e

interesit, nesër, pasnesër, deri javën tjetër kemi kohë, deri më 26 shkurt që do kaloj kjo sipas kalendarit që është në parlament.

Të bëjmë një proces konsensual, t'i pyesim aktorët e interesit, se mbase na thonë ndonjë mendim. E dini se çfarë procesi konsensual do bëjmë me këta? Do bëjmë një proces konsensual, që do ketë 61 Këshilla Bashkie? Do ketë. Do ketë kaq këshilltarë? Do ketë. Pra, do bëjmë një proces konsensual në funksion të këtyre neneve teknike, nuk do bëjmë proces konsensual për decentralizimin, sepse ajo do bëhet në një fazë tjetër kur të vijë projektligji i shkruar tamam e bardha mbi të zezë, një ligj i ri nga e para për 8652.

Pra, konsensualiteti që ne kërkojmë edhe prej aktorëve të interesit, që do të kërkojmë ta bëjmë zoti Kryetar, është në funksion të këtyre neneve, që janë në këtë projektligj, se ne nuk do kërkojmë paradhënie mendimi për decentralizimin të aktorit të interesit, dhe kur të flasim prapë në muajin korrik apo në muajin gusht, se unë shpresoj që gjatë muajit gusht apo shtator të fillojë diskutimi i decentralizimit, mbas zgjedhjeve të kryetarëve të bashkive, atëherë do t'i thërrasim përsëri ata që të bëjmë një proces sa më të gjerë.

Në përfundim unë them që ta miratojmë në parim këtë projektligj, që është teknik dhe të lëmë të hapur një proces konsensual me aktorët e interesit, OJQ-të e ndryshme, Këshillin e Evropës, të vijnë këtu, ose në nënkomisionin që unë drejtoj, ose në komisionin që drejtoni ju, njësoj është, se nënkomisioni është pjesë përbërëse e komisionit siç e di unë rregulloren, dhe i raporton komisionit të madh të këtij procesi me këto faktor interesi, dhe pasi të dëgjojmë edhe ata të kalojmë nën për nën këtë projektligj. Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Fino!

I mbyllem këtu diskutimet, dakord edhe me propozimin e bërë edhe nga relatori, përfundimisht, për organizimin e seancave dëgjimore.

Zoti Fino në cilësinë e relatorit do çmohet nga grupi i opozitës zoti Bylykbashi, ose cilido nga kolegët e vet. Dakord! Të takohen që të vendosin se cilat janë organizatat që do ftohen, ku do të ftohen, si do të ftohen, për çfarë do të ftohen, dhe për të bërë të gjitha modalitetet e nevojshme për organizimin e këtyre seancave dëgjimore.

Unë e mirëkuptoj vullnetin e kolegëve të mi të maxhorancës, për të respektuar këtë kërkesë të opozitës, dhe nuk ka asgjë të keqe, se kjo ka qenë në natyrën dhe mënyrën e funksionimit të këtij komisioni gjatë gjithë kësaj legjislature. Nuk ka arsye pse bëjmë përjashtim, edhe kur e kërkon opozita një gjë që ne e kemi bërë si pjesë të metodologjisë së punës.

Atëherë, kush është dakord në parim? Kundër? Dy kundër.

Miratohet!

Për procedurë ju lutem para se ta mbyll.. *(Diskutime pa mikrofon)*

Ju lutem, zoti Strazimiri për procedurën.

Gent Strazimiri – E mora fjalën për procedurë, por ma dhatë pak vonë, se mbas votimit nuk ka më kuptim, megjithatë më lejoni ta shpreh se sapo votuam një ligj që qenka vjetërsuar.

Do të duhet të vij një i ri që të bëj punën që nuk e bëka dot ky ligj. Pse e votuam, nuk po e kuptoj? Pse po i bëjmë këto gjëra? Ndoshta, meqenëse relatori tha: “që ky është i vjetërsuar tashmë, do bëjmë një tjetër në shtator”. Juve ju vjetërsohen ligjet përpara se t’i miratoni zotëri.

Fatmir Xhafaj – Dakord! Kjo është “kur e shikon kalin nga patkonjtë”, por nuk ka problem. Ne do t’i propozojmë seancës plenare riformatimin e dy nënkomisioneve dhe ngritjen e një nënkomisioni të ri. Për efekt riformatimi, për efekt të ndryshimeve në përbërjen e komisionit, propozoj që për Nënkomisionin e Qeverisjes Vendore të jenë anëtarë nga maxhoranca zotërinjtë Fino, Vasili dhe Peza. Tre nga maxhoranca dhe dy nga opozita, pesë veta. Ju lutem zotërinjve të opozitës të bëjnë propozimet të tyre.

Për Nënkomisionin e të Drejtave të Njeriut zonja Hysi, zonja Caka dhe zoti Majko. Te të gjitha nënkomisionet nga dy veta ka opozita, kjo është rregullorja.

Për Nënkomisionin e Administratës Publike zoti Klosi, zoti Muçmataj dhe zoti Subashi.

A jemi dakord, meqë emrat do t’i çoni seancës edhe ju besoj?

Kush është dakord t’ia propozojmë seancës? Dakord. Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet!

I kalohet dhe kjo seancës. Faleminderit! Ditë të mbarë!

MBLEDHJA MBYLLET

